

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7830 E diel 24 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Kumti i djeshëm i numrit një të partisë së sotme në pushtet (kryeministrit të vendit) se, nëse partitë opozitare të vetëmërguara nga Kuvendi fitojnë një bashki të vetme ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Tango dyshe kërkon më shumë




Opinion *i* **Ditës**

Nga JORGJI KOTE

Zonja e Ndjerë e Shkodrës dhe e kulturës shqiptare

Kisha dëgjuar për profesoren e Knjohur të ekonomisë qysh në mesin e viteve '80 dhe veçanërisht mbi angazhimin e saj si prurje e re origjinale në jetën ...
Vijon në faqen 22



Prapaskenat e kongresit, mungon Nano

Rama: Zgjedhje para kohe po morët një bashki më shumë. Basha: Fiton opozita

PS: Nuk e ndërpresim mandatin qeverisës.
Konfirmohen 7 kandidatët e parë të 30 qershorit.

Partia Socialiste ka mbajtur dje kongresin elektoral, i cili përveçse konfirmoi qëndrimin e mazhorancës për të vijuar qeverisjen, ishte edhe një shfaqje force ndaj opozitës, e cila nga ana e saj ka braktisur Kuvendin dhe ka dalë për të protestuar në rrugë. Pas 7 orësh diskutime të majtët miratuan me votë unanime në kongres një deklaratë të përbashkët ...
Në faqet 2-3

LISTA E RE/ FAMILJET QE PERFITOJNE NE TIRANE DHE NE 4 RRETHE TE VENDIT

EMRAT, 600 PRONARET QE MARRIN TAPINE E TRUALLIT

Ndërtuan në tokën e shtetit ose të të tretëve, marrin certifikatën e pronësisë për pronën. Vendimi i qeverisë, sipërfaqja që merr secili. Publikohen tabelat



(Në foto) Ndërtime informale

Në faqen 6

ARRESTOHET AUTOR

Krimi në familje trondit Gramshin, burri mbyt me duar nënën e 3 fëmijëve

Në faqen 8

HETIMET

Atentati mafioz në Elbasan, kamerat filmuan vrasjen e avokatit Ravik Gurra

Në faqen 9

NDRYSHON LIGJI

Toka e përfituar me ligjin 7501, shtohen 3 kategori që mund të përfitojnë tapi

Në faqen 7

DOSSIER

Konferenca e Tiranës që tronditi Enver Hoxhën pas Kongresit të Moskës

Në faqen 10-11

SOT NE "MILOSAO"



EKSKLUZIVE

Sami Frashëri "i zakonshëm" në sytë dhe kujtimet e vajzës së tij, Samijes

Suplement

Emrat/ Kush janë kandidatët për këshillin bashkiak të Tiranës. Disa zv/ministra

Gaz Paja, Redi Jupi, ja 100 këshilltarët e PS

Veliaj: Me Ramën më pranë se kurrë. Fitojmë edhe tek Unaza e Re

Erion Veliaj është zyrtarisht kandidat i Partisë Socialiste për një mandat të dytë për Bashkinë e Tiranës. Kryeministri Edi Rama në takimin "Bashkia që duam" të organizuar në sheshin "Nënë Tereza", ka shuajtur çdo pikëpyetje dhe dyshim,



duke konfirmuar Veliajn për një mandat të dytë në krye të bashkisë më të madhe të vendit. Ai kërkoi prej qytetarëve që kishin mbushur sheshin që të mbështesin Veliajn dhe ekipin e tij në zgjedhjet e ardhshme duke theksuar se së bashku ata do bënin ...
Në faqen 4

SOCIALISTET KONGRESI

Socialistët kanë konfirmuar qëndrimin për të vijuar mandatin qeverisës deri në fund

PS 7 orë kongres, konfirmohet qeverisja dhe kandidatët e parë

I vetmi vendim i kongresit ishte miratimi i deklaratës

Partia Socialiste ka mbajtur dje kongresin elektoral, i cili përveçse konfirmoi qëndrimin e mazhorancës për të vijuar qeverisjen, ishte edhe një shfaqje force ndaj opozitës, e cila nga ana e saj ka braktisur Kuvendin dhe ka dalë për të protestuar në rrugë. Pas 7 orësh diskutime të majtë miratuan me votë unanime në kongres një deklaratë të përbashkët përmes së cilës theksuan se PS është e vetmja forcë politike që mund të qeverisë vendin dhe të garantojë të ardhmen integruar të vendit, ndërsa bën edhe konfirmimin e 7 kandidatëve të parë për zgjedhjet vendore të 30 qershorit, 5 prej të cilëve janë kryebashkiakë që rikonfirmohen sërish.

KONGRESI

Kongresi nisi me ekzekutimin e Himnit Kombëtar nga këngëtarja Marsela Çibukaj dhe më pas punimet u çelën nga Sekretari i Përgjithshëm i PS-së, Taulant Balla, i cili në fjalën e tij ndërsa bëri një përmbledhje të shkurtër të arritjeve të PS në këto 5 vite e gjysmë qeverisje, theksoi se ajo mbetet e vendosur për të përmbytur deri në fund kontratën me zgjedhësit. Balla tha se PS do rikonfirmohet jo vetëm në bashkitë që ka fituar në zgjedhjet e kaluara por edhe në bashkitë që sipas tij mbahen peng nga opozita, ndërsa shtoi se PS është e gatshme për çdo lloj dialogu parlamentar në shërbim të vendit dhe qytetarëve. Pas tij fjalën e kanë marrë me radhë zëvendëskryeministri, Erion Braçe dhe ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, të cilët kanë folur mbi reformën e shërbimeve dhe luftën kundër korrupsionit. "Rreth 22 513 shqiptarë kanë marrë më në fund shërbim publik nga qeveria e Shqipërisë, pas ankesës së tyre në platformën e bashkëqeverisjes "shqipëriaqeduam.al", - u shpreh Braçe. Më pas në skenën e kongresit janë ftuar edhe shumë qytetarë që kanë dëshnuar rastet konkrete të zgjidhjes së problemeve nëpërmjet kësaj platforme. Kongresi ka vijuar punimet



KANDIDATËT

Dritan Leli në Vlorë, Sotiraj Filo në Korçë, Armando Subashi në Fier, Majlinda Bufi në Roskovec, Pjerin Ndreu në Lezhë dhe Gledian Llatja në Elbasan u konfirmuan si kandidatë për kryetar bashkie për zgjedhjet e 30 qershorit. U konfirmua edhe Erion Veliq për një mandat të dytë për Bashkinë e Tiranës. Kështu shkon në 7 numri i kandidatëve të konfirmuar.

Pëllumbi: PS në zgjedhje dhe pa opozitën, Meta deklarata në panik

Ish-kryetari i Kuvendit, Servet Pëllumbi, teksa mori pjesë në punimet e kongresit u shpreh dje për mediat se nuk ka asgjë të jashtëzakonshme në krizën politike në Shqipëri. "Mendoj se nuk ka ndonjë gjë të jashtëzakonshme, këto situata ndodhin edhe në vende të tjera. Jelevverdhët në Francë kanë 5 muaj dhe Macroni vazhdon punën i qetë. Ata kanë të drejtë të protestojnë, kur e teprinë shteti vepron me mjetet që i lejon ligji. Në Shqipëri nuk janë jelevverdhët biles edhe jeleku antiplumb i Berishës është vjetërsuar", - tha Pëllumbi. Gjithsesi ai theksoi se ky kongres është i një rëndësie të veçantë për situatën që po kalon vendi. Ai hodhi posh-



të edhe mundësinë që në vend të mbahen zgjedhjet të parakohshme, duke shtuar se qeverisja është legjitime. "Nuk ka pse bëhen zgjedhjet të parakohshme, në kushtetutë është përcaktuar: zgjedhjet bëhen një herë në 4 vjet dhe mund të bëhen zgjedhjet të parakohshme kur humbet mazhorancës qeverisëse, nuk qeveris dot dhe nuk miraton dot një ligj, derisa një kusht të

tillë nuk e kemi nuk ka pse të ketë zgjedhje se është mundim i madh për popullin dhe minus për demokracinë", - shtoi Pëllumbi. Në këtë kuadër ai theksoi se nuk arsyen pse mazhoranca të mos shkojë edhe në zgjedhjet vendore edhe nëse opozita do të bojkotojë ato. "Mirë është të jetë opozita, por opozita nuk është ata që dalin e rrethojnë parlamentin, opozita është tek populli. Marrin nuk marrin pjesë forcat politike popullore do votojë të zgjedhë përfaqësuesit e vet, qofshin të pavarur apo partiak", - tha ai. I pyetur për deklaratat e presidentit Ilir Meta, ish-kryetari i Kuvendit u shpreh: "Deklaratat që kanë panik, nuk komentohen".


me fjalimet e disa ministrave si Belinda Balluku, Ogerta Manstirliu, Blendi Klosi, apo Besa Shahini, të cilët, gjithashtu, kanë folur mbi sfidat dhe arritjet e qeverisë sipas sektorëve dhe fushave që mbulojnë.

KONFIRMIMET

Kongresi ka vijuar më pas me fjalimet e shkurtra të disa

prej kryebashkiakëve që për socialistët janë modele suksesi, si Dritan Leli në Vlorë, Sotiraj Filo në Korçë, Armando Subashi në Fier dhe Majlinda Bufi në Roskovec. Natyrisht që fjala e tyre në këtë kongres ishte dhe një lloj konfirmimi për të kandiduar për një mandat tjetër në bashkitë që ata drejtojnë. E bashkë me ta në

skenën u ngjiten edhe deputeti Pjerin Ndreu dhe prefekti i Elbasanit Gledian Llatja, të dy këta si kandidatë për kryetar bashkie në Lezhë dhe në Elbasan. Bashkë edhe me Erion Veliqin që u konfirmua në sesionin e dytë, këta janë 7 kandidatët e parë që PS konfirmoi për zgjedhjet e ardhshme vendore. Kongresi ka vijuar



Nga mungesa e Nanos te kafet për gazetarët, ç' ndodhi në kongres

Kongresi i djeshëm i socialistëve ishte organizuar për të treguar së pari, forcën e socialistëve përballë opozitës, por edhe për të demonstruar një tjetër sjellje nga ajo që kanë shfaqur opozitarët në protestat e tyre. Ndaj organizatorët ishin kujdesur si për masivitetin e pjesëmarrësve ashtu edhe për anën e spektaklit, ku nuk munguan edhe performanca e këngëtarëve të njohur siç është rasti i Aurela Gaçe apo Marsela Çibukaj. Ndërkohe që për ta bërë më të lehtë përcjelljen e mesazheve të kongresit në gjithë bulevardin nga sheshi "Nënë Tereza" deri te kryeministria ishin vendosur ekrane LED dhe bokse të mëdha zëri. Ndryshe nga sa ishte lajmëruar më parë në kongres nuk mori pjesë ish-kryetari Fatos Nano, ashtu siç ra në sy edhe mungesa e ish-presidentit socialist Rexhep Mejdani. I vetmi që ishte i pranishëm nga "senatorët" e PS ishte ish-kryetari i Kuvendit Servet Pëllumbi. Gjithashtu, ranë në sy edhe mungesa e disa prej aleatëve të PS-së, si Skënder Gjini apo Paskal Milo, ndërsa të pranishëm ishin komunistët dhe disa aleatë të tjerë të vegjël. Por pavarësisht akreditimit disa ditë më parë, media nuk u lejua të ishte e pranishme në sallën ku zhvillohej kongresi. Organizatorët kishin menduar që gazetarët dhe kamerat të qëndronin vetëm në holl, ku mund të merrnin drejtues të PS në intervista. Gjithashtu, si për ta mbajtur mirë me gazetarët, organizatorët kishin kontraktuar edhe shërbim katering, ku kamerierët servirnin për gazetarët dhe të pranishmit e tjerë në holl kafe, ujë dhe ushqime.

me fjalimet e zëvendëskryeministrit të Jashtëm, Gent Cakaj dhe ministres për Mbrojtjen e Parlamentit, Elisa Spiropali dhe pas edhe me miratimin e një deklaratë si qëndrim të PS-së për situatën politike. Me kaq u mbyll sesioni i parë i punimeve të kongresit dhe të gjithë delegatët e tij, përshë kryeministrit Rama ecën në këmbë për t'u bashkuar mijëra qytetarëve që kishin mbushur sheshin "Nënë Tereza" dhe një pjesë të mirë të bulevardit "Dëshmorët e Kombit", ku dhe

u bë prezantimi i Veliqit për një mandat të dytë. Në fund Kongresi vazhdoi punimet me tre panele të ndryshme takimesh në tre ambiente të veganta, dy në Pallatin e Kongreseve dhe një në ish-hotel "Sheraton", ku diskutua qëndrimi i PS për reformën zgjedhore, si dhe çështjet e qeverisjes lokale dhe edukimit dhe punësimit i të rinjve. Në fund kongresin e mbylli Taulant Balla nëpërmjet një deklaratë për mediat, ku dhe bëri një përmbledhje të shkurtër të arritjeve të 7 orë mbledhje.



DEKLARATA

"Kemi duruar baltën, vezët dhe bojën e dëshpërimit të tyre mbi fytyrat tona. Në vend që të na sfidonin në fushën e demokracisë kanë vendosur që ta bëjnë Shqipërinë që të duket ai vendi i mbytur. Ta harrojnë pushtetin në tavolinë", -tha kryeministri.

SHKURT

Mazhoranca nis ofensivën: Ta harrojnë pushtetin në tavolinë

Kongresi i djeshëm duket se do jetë dhe pika e kthesës së qëndrimit që do mbajë tashmë mazhoranca karshi opozitës dhe të gjithëve atyre që sulmojnë institucionet. Kreu i qeverisë Edi Rama ka qenë i ashpër dhe prerë dje në fjalën e tij, se koha kur mazhoranca kafshonte gjuhën për të mos agruar me tej situatën ka marrë fund. Sipas tij tashmë ajo do të jetë në një ofensivë totale ndaj të gjithë atyre që kërkojnë të cenojnë ligjet demokratike. "Sot mbaron ecja jonë në majë të gishtave dhe nis një ofensivë frontale. Kohët e fundit e kemi kafshuar shpesh gjuhën për ata që e duan Shqipërinë shesh për përheshin e tyre. I kemi parë sulmet e tyre ndaj vendit, kur kanë sulmuar qeverinë duke eksportuar nëpër botë shfaqjet e turpshme, kur kanë sulmuar prokurorinë e shtetit dhe vetë reformën në drejtësi sa herë vetingu nxjerr nga pallati shërbëtorët e tyre. I kemi parë kur kanë sulmuar Shqipërinë në çdo kanal të huaj kur kanë pasur mundësi të fusin hundët e tyre. U kemi ofruar sa kemi mundur bashkëpunim për reformën zgjedhore dhe jo vetë. Kemi duruar baltën, vezët dhe bojën e dëshpërimit të tyre mbi fytyrat tona. Në vend që të na sfidonin në fushën e demokracisë kanë vendosur që ta bëjnë Shqipërinë që të duket ai vendi i mbytur. Ta harrojnë pushtetin në tavolinë", -tha kryeministri.

Kryeministri ironizon Bashën: Lider pa "hallate", pret karamele

Kreu i qeverisë fjalën e tij e ka shoqëruar me plotë batuta teksa ka ironizuar dy liderët e opozitës, kryetarin e PD-së Lulzim Basha dhe kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi. Rama ka theksuar se Basha pret karamelen e radhës duke lënë të kuptohet se pret fitoren në tavolinë, ndërsa Kryemadhi kërkon pushtet për përfituar ekonomikisht. "Lulzim Basha është si lider pa "hallate" që djeg mandatin e deputetëve. Për arushën Lul që bërtet për karamelen e radhës, as për shoqen Mona që ulërin për trastën e radhës, dhe askush nuk futet në zgjedhje, por askujt nuk mund t'i ndalohet të zgjedhë dhe të zgjidhet", - tha Rama.

Kreu i qeverisë ka përjashtuar çdo mundësi që ta lërë pushtetin veçse me votë

Rama sfidon opozitën: Fitoni një bashki më shumë, shkojmë në zgjedhje

"Basha s'fiton dot as në partinë e tij, po të mos i vjedhë"

Kryeministri Edi Rama ka sfiduar opozitën teksa i ka ofruar një zgjidhje për krizën politike fitoren e një bashkie më shumë në zgjedhjet vendore. Nga sheshi "Nënë Tereza" kryeministri Edi Rama përmes një fjalimi që zgjati afro 1 orë, i ofroi ndër të tjera opozitës mundësinë për të garuar në zgjedhjet e ardhshme vendore dhe nëse ajo do arrijë të fitojë qoftë edhe një bashki më shumë, atëherë sipas tij mazhoranca do të pranojë që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme në shtator.

"Nëse në 30 qershor fitoni një bashki më shumë se ne jemi gati të shkojmë në zgjedhje të parakohshme që në vjeshtë. E di që ju Lulzim dhe ju pas Lulzimit nuk do e pranoi këtë sfidë se e dini ndaj keni dalë në rrugë, që aleancën e PS me njerëzit nuk e mundin dot me zgjedhje as në Kukës, as në Skrapar lërë më pastaj në gjithë Shqipëri", -tha Rama. Jo vetëm kaq, por ai i ofroi opozitës mundësinë që së bashku të bëjnë ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor, që nga numërimi elektronik, depolitizimi i komisioneve dhe deri tek ashpërsimi e dënimit për shitblerjen e votave. "Një ftesë e kam ende për ju. Jeni ju që i keni rrokasinur kokën shqiptarëve dhe miqve ndërkombëtarë për reformën zgjedhore, dhe që keni mbajtur peng Shqipërinë për votimin elektronik, hajdeni ulemi, ta miratojmë së bashku atë reformë, të biem dakord, t'i eksperimentojmë në disa zona, që në 30 qershor të eksperimentojmë votimin elektronik. Dhe meqë e kemi qejf edhe shitblerjen e votës, jemi gati të miratojmë në zgjedhjet e masë të fortë kundër këtij fenomeni, çdo masë që mund të propozojë doktoresha e shkencave, Kryemadhi, pastaj e kalojmë vetë në Kuvend me deputetët e rinj, ata i keni zgjedhur ju jo ne", - shtoi kryeministri. Nga ana tjetër ai theksoi se mazhoranca nuk ka mandat qeverisës për të degur, duke hedhur poshtë kështu çdo mundësi që opozita nëpërmjet djegies së mandatëve të deputetëve dhe protestave ta detyrojë atë të largohet nga pushteti. "I them Lulzim Bashës dhe atyre që e ndjekin pas: Na vjen turp për ju, dhe na vjen keq për ata që braktisët që votuan për ju. Por është e drejta juaj t'i tradhëtoni, turpin e Shqipërisë dhe historisë së parlamentarizmit sh-



META

"LSI sot nuk përfaqëson askënd, por po ta besojnë Monikën, LSI nuk përfaqëson më as Ilir Metën. Meta ndihet kaq i papërfaqësuar sa që i duket sikur një juntë ushtarake do sulmojë pallatin presidencial. Zoti president, e di që më dëgjon, rri i qetë jemi dhe do të mbetemi gjithmonë vendi i NATO-s. Të garantoj që sa të kemi Pandin ky vend nuk del nga NATO. Në fund të ditës fundi politik i Lulit e Monikës nuk duhet të jetë problem i yti dhe i yni. Zoti president rri i qetë dhe mos i çojë më nëpër mend ato çudira", - u shpreh Rama.

"Zgjedhje nëse merrni një bashki më shumë"

PD refuzon ofertën e Ramës: Më lini t'i vjedh edhe zgjedhjet vendore

Partia Demokratike refuzoi ofertën e kryeministrit Edi Rama, i cili sfidoi opozitën duke i thënë që nëse fitojnë një bashki më shumë se PS në zgjedhjet e 30 qershorit, vendi atëherë do të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Përgjigjja refuzuese erdhi nga Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazmet Bardhi i cili në një postim në rrjetet sociale shkruan: "Propozimi i Ramës për zgjedhjen e krizës: "Më lini t'i vjedh edhe zgjedhjet vendore

dhe po t'i fitojë opozita zgjedhjet që unë do vjedh, shkojmë pastaj në zgjedhje të parakohshme". Për sekretarin e përgjithshëm të PD, Kongresi i PS0së ishte një shpenzim marramendës që nuk e arriti dot qëllimin propagandistik. I ftuar dje në News 24 Bardhi tha se Rama foli me një gjuhë urretjeje ndaj opozitës, pasi prej kohës e ka humbur qetësinë. "Kongresi ishte një shpenzim marramendës që nuk e arriti dot qëllimin propagandistik, një mbledhje partie që tentuan ta kthejnë në

shfaqje e nuk e bënë dot. Edhe fjalimi i mërziutur i Ramës e tregon këtë, e ktheu në fjalim urretjeje ndaj opozitës. Është nervoz dhe ka humbur prej kohës qetësinë. Opozita është në rrugën e vet të drejtë. Nuk kemi nevojë të urdhërojmë punonjësit të na bashkohen në aksionin tonë politik, siç bëri PS. As punonjësit e administratës nuk i përgjigjen. Nga 16 shkurti është vrarë frika, regjimit të Ramës po i vjen fundi", -theksoi z.Bardhi.

qiptar, ne nuk kemi mandat t'ju japim pushtet në tavolinë", - u shpreh Rama. Por, nëse opozita nuk do i pranojë këto oferta të mazhorancës dhe nuk do futet në zgjedhjet e 30 qershorit, kreu i mazhorancës theksoi se kjo nuk do të ishte sërish problem. "Keni nisur avazin se nuk futeni në zgjedhje. Punë e madhe fort. I humbët zgjedhjet me qeverinë tuaj dhe prapësprapë e nxitë Shqipërinë në çdo gjuhë të huaj. Pushteti nuk është qoftë të daja dhe nuk është cirk për arushim Lul që bërtet për karamelen e radhës. Ka ardhur koha që kjo valle me maska të mbarojë", - tha më tej Rama. Ai akuzoi kreun e opozitës se të gjithë këtë përpjekje për të

krijuar këtë situatë e bën pasi kërkon pushtet në tavolinë, pasi siç tha Rama ai nuk fiton dot me votë. Madje kreu i qeverisë ka ironizuar se Basha nuk fiton dot as në partinë e tij. "Basha i ka tmerr zgjedhjet, sepse nuk i fiton dot, nuk i fiton dot as në partinë e tij, po të mos i vjedh, lërë më t'i fitojë në mexhllisin e gjerë. Madje, kam një dyshim, sikur ne të mos futemi në zgjedhjet e qershorit dhe Lul të futet vetëm, prapë nuk i fiton zgjedhjet, sepse njerëzit nuk e pranojnë dot dhe jo më ta votojnë", - u shpreh Rama. Kreu i qeverisë nuk ka lënë pa sulmuar as Presidentin e Republikës, për qëndrimet që ka mbajtur dhe deklaratat e tij

për vetëflim apo për dorëheqje nga posti i kreut të shtetit. "LSI sot nuk përfaqëson askënd, por po ta besojnë Monikën, LSI nuk përfaqëson më as Ilir Metën. Meta ndihet kaq i papërfaqësuar sa që i duket sikur një juntë ushtarake do sulmojë pallatin presidencial. Zoti president, e di që më dëgjon, rri i qetë jemi dhe do të mbetemi gjithmonë vendi i NATO-s. Të garantoj që sa të kemi Pandin ky vend nuk del nga NATO. Në fund të ditës fundi politik i Lulit e Monikës nuk duhet të jetë problem i yti dhe i yni. Zoti president rri i qetë dhe mos i çojë më nëpër mend ato çudira", - u shpreh Rama.

ZGJEDHJET KANDIDIMI

Mandati i ri, kryeministri: Me Erionin do bëjmë 4 herë më shumë për kryeqytetin

Veliaj rikandidon në Tiranë: Me Ramën jemi më bashkë se kurrë

"PS do jetë numri një edhe në zonën e Astirit"

Erion Veliaj është zyrtarisht kandidat i Partisë Socialiste për një mandat të dytë për Bashkinë e Tiranës. Kryeministri Edi Rama në takimin "Bashkia që duam" të organizuar në sheshin "Nënë Tereza", ka shpjeguar që pikëpyetje dhe dyshim, duke konfirmuar Veliajin për një mandat të dytë në krye të bashkisë më të madhe të vendit. Ai kërkoi prej qytetarëve që kishin mbushur sheshin që të mbështesin Veliajin dhe ekipin e tij në zgjedhjet e ardhshme duke theksuar se së bashku ata do bëjnë shumë më tepër se sa është bërë deri më tani për Tiranën. Duke vlerësuar kryebashkiakun Veliaj për punën e bërë në këto katër vite duke transformuar Tiranën, Rama siguroi se besimi për Erion Veliajin dhe PS në 30 qershor do të sjellë dhe katërfishin e punëve që janë bërë në mandatin e parë. "Kjo Tiranë sot nuk ka asnjë lidhje me atë që ju patëm me sytë e kujtesës. Është një provë e dallimit të madh, nata me ditën, mes nesh dhe atyre që i kemi mburapa, çdo ditë e më mburapa. Tiranë jonë sot, ashtu si çdo qytet tjetër që qeverisim, edhe si vetë Shqipëria, nuk ka të krahasuar me çka ishte para se ne ta merrnim në dorë. Sot Tirana europiane nuk është më një vegim, por është një realitet në formim e sipër". - tha Rama. Ndërkohë që Veliaj Erion Veliaj në fjalën e tij gjatë këtij takimi u shpreh se me mbështetjen e qeverisë socialiste, është i vendosur që ta çojë Tiranën përpara për ta bërë atë një qytet të denjë evropian. "Pati nga ata që filluan të bënin diversion dhe thoshin, Erioni dhe Edi s'i kanë punët mirë, nuk flasin. Dëshpërimi duhet të jetë aq i madh sa e vetmja shpresë që ata të kenë ndonjë shans është që të zihemi ne. Më vjen keq t'u zhgënjëj po unë dhe Edi Rama jemi më bashkë se kurrë, më të fortë se kurrë, më të vendosur se kurrë të çojmë përpara Tiranën dhe ai të çojë përpara Shqipërinë dhe ambientin tonë evropian", - tha Veliaj.




DIVERSIONI
"Pati nga ata që filluan të bënin diversion dhe thoshin, Erioni dhe Edi s'i kanë punët mirë, nuk flasin. Dëshpërimi duhet të jetë aq i madh sa e vetmja shpresë që ata të kenë ndonjë shans është që të zihemi ne. Më vjen keq t'u zhgënjëj po unë dhe Edi Rama jemi më bashkë se kurrë, më të fortë se kurrë, më të vendosur se kurrë të çojmë përpara Tiranën dhe ai të çojë përpara Shqipërinë dhe ambientin tonë evropian", - tha Veliaj.

Nga profesorët te zv.ministrat, ja 100 kandidatët për këshilltarë

Pas zyrtarizimit të kandidatës së kryebashkiakut Erion Veliaj për një mandat të dytë në Tiranë, qytetarët e kryeqytetit janë njohur nga Erion Veliaj edhe me emrat e 100 kandidatëve për Këshillin Bashkiak, me të cilët Partia Socialiste do të përfaqësohet në zgjedhjet e 30 qershorit. Ndryshe nga zgjedhjet e 2015-ës, kur kandidatët për këshilltarë ishin 61 (sa ç'është edhe numri maksimal i Këshillit Bashkiak të Tiranës), kësaj here Partia Socialiste, siç e ka shpjeguar më herët edhe Veliaj, ka sjellë një listë me 100 kandidatë për t'i paraprirë ndonjë bojkoti të mundshëm të zgjedhjeve nga ana e PD-LSI. Por, nga ana tjetër, Këshilli Bashkiak i Tiranës

është bërë shpeshherë edhe trampolinë për të kaluar si deputet në parlament, siç ndodhi në vitin 2017, ku këshilltarë si Elisa Spiropali apo Klodilda Ferhati u zgjedhën deputetë të PS-së. Lista pasqyron një ndërthurje të zgjedhurish mes qeverisë dhe bashkisë, ku spikasin një sërë zëvendësministrash të qeverisë Rama, të cilët kandidojnë për një vend në Këshillin Bashkiak. Nga ana tjetër, vihet re një numër i madh pedagogësh e profesorësh. Një fokus i veçantë duket se i është dhënë të rinjve, ku bien në sy mbi 30 të rinj nën moshën 30 vjeç; çka e konfirmon edhe njëherë Veliajin si promotor të të rinjve për të qenë pjesë aktive e vendimmarrjes së qytetit.

por edhe se Tirana është një nga finalistet për të qenë kryeqyteti i Europës për rininë në vitin 2022. Disa nga emrat publik janë aktori Gazmend Paja apo edhe ish-futbollisti Redi Jupi, Artur Sula, Olti Rrumbullaku dhe Klodiana Beshku janë emrat e spikatur nga katedrat e universiteteve, që janë pjesë e listës së kandidatëve. Në listë spikasin një numër i lartë zëvendësministrash, të gjithë të rinj, të cilët me sa duket Këshillin Bashkiak të Tiranës do ta kenë edhe si një lloj "trampoline", për të fituar eksperiencë të vyer në debatimin e çështjeve me rëndësi për qytetin.



LISTA, GAZMEND PAJA E REDI JUPI NË EKIPIN E KËSHILLTARËVE.

- | | | |
|-----------------------|-------------------------|----------------------|
| 1. Abdyl Sarja | 34. Ervin Meta | 68. Luiza Grazhdani |
| 2. Agim Kraja | 35. Etjen Xhafaj | 69. Marjana Suli |
| 3. Aida Llazani | 36. Eugerta Teqja | 70. Maura Linadi |
| 4. Albert Nikolla | 37. Eugerta Baku | 71. Meli Kondi |
| 5. Aldrin Dalipi | 38. Fabjan Azuni | 72. Militan Marku |
| 6. Alketa Hila | 39. Fatmir Heti | 73. Mira Rakacolli |
| 7. Alketa Cobo | 40. Fjoralba Jahupi | 74. Naim Halili |
| 8. Anxhela Bakiasi | 41. Flavio Barci | 75. Neki Hoxha |
| 9. Aqif Qefalia | 42. Frida Kriçka | 76. Olsa Ulqinaku |
| 10. Arnisa Lushaj | 43. Gaz Paja | 77. Olti Rrumbullaku |
| 11. Arta Dollani | 44. Geldi Belba | 78. Orion Gliozheni |
| 12. Arta Harxhi | 45. Genc Duka | 79. Ornela Cuci |
| 13. Artur Sala | 46. Genta Mezinj | 80. Petrit Desku |
| 14. Auran Xhani | 47. Gerta Pellumbi | 81. Plarent Ndreca |
| 15. Bajram Shera | 48. Glindkhet Madhi | 82. Rajsi Hamza |
| 16. Bardha Sadikaj | 49. Grejs Bixhi | 83. Ramazan Bueci |
| 17. Bardhylla Kospiri | 50. Gresa Hoxha | 84. Rasim Hidri |
| 18. Besfort Lamallari | 51. Hantini Bonati | 85. Redi Jupi |
| 19. Blerina Dorcaja | 52. Iva Beharaj | 86. Roi Bashaj |
| 20. Blerina Vorpqi | 53. Jeton Skenderaj | 87. Romina Kuko |
| 21. Bora Panajoti | 54. Joleza Koka | 88. Rona Serjani |
| 22. Dajna Sorenson | 55. Jonida Mema | 89. Rovena Voda |
| 23. Darling Mersini | 56. Julian Hima | 90. Rudolf Xhillari |
| 24. Dorian Balla | 57. Julian Hodaj | 91. Ruilida Lite |
| 25. Dorina Kuka | 58. Kamela Banushi | 92. Sara Shameti |
| 26. Egert Vargu | 59. Karolina Kostallari | 93. Sonila Qato |
| 27. Eni Bistri | 60. Katerina Marku | 94. Ted Deraj |
| 28. Eni Pellumbi | 61. Klevi Lala | 95. Teuta Vodo |
| 29. Enis Hoxha | 62. Klodeta Dibra | 96. Toni Gogu |
| 30. Erald Mara | 63. Klodiana Beshku | 97. Valbona Zeka |
| 31. Eralda Shqarshi | 64. Koli Bele | 98. Xheni Hatillari |
| 32. Eridian Saliqj | 65. Laureta Sinanaj | 99. Xhensila Visha |
| 33. Ermira Gjeci | 66. Liri Jani | 100. Ylli Çano |
| | 67. Luan Bregasi | |

qipërinë dhe ambientin tonë evropian", - tha Veliaj. Ai bëri një prezantim të shkurtër të punëve të bëra në gjithë Tiranën në këto 3 vite e gjysmë, duke theksuar se në mandatin e dytë do bëjë shumë më shumë për Tiranën. Ai u ndal edhe të disa nga investimet madhore në Tiranë që janë kthyer në vendet më të preferuara për qytetarët dhe turistët. Gjithashtu, ai theksoi

se transformimi i madh që ka pësuar gjithë Tirana janë garancia edhe se Tirana do ketë një unazë të re moderne, një teatër dinjtoz dhe një piramidë që do kthehet në një qendër të zhvillimit të teknologjisë për të rinjtë. Ai theksoi se një pakicë e zhurmshme nuk mund të jetë pengesë e zhvillimit që mbështetet nga shumicat e heshtura. "Partia Socialiste do të jetë numri një edhe në

zonën e Astirit, përtej një minorance që bën zhurmë, ka një shumicë të heshtur që nuk e pranon bullizmin, nuk e pranon që një grup i vogël, një grup i përdorur, një grup i zhurmshëm të na caktojë axhendën e shumicës së njerëzve të ndershëm dhe të familjeve tona. Ne në Tiranë jemi të vendosur që t'i themi jo bullizmit, jo vandalëve, jo atyre që shkatërrojnë qytetin, jo atyre

që përdhosin Tiranën", tha Veliaj. Ndaj për ta bërë realitet ëndrrën e Tiranës evropiane, Veliaj ftoi gjithë qytetarët e Tiranës që të mbështesin PS-në dhe ekipin e Bashkisë së Tiranës. "Disa prej nesh vazhdojnë të sillen ende me kompleksin e Rozafës, në ndërto ata prish. Por di t'u them se kjo betejë do të fitohet nga ata që ndërtojnë dhe jo nga ata që prishin. Nga sot kemi 100 ditë dhe sikur secili

prej nesh nga 100 mijë veta që jemi sot në këto 100 ditë të takojmë vetëm 1 njeri që nuk i është bashkuar atëherë në fund të 100 ditëve ne do kemi takuar 100 vetë. Sa prej nesh do takojmë një njeri që do t'i bashkohet progresit dhe që do Shqipërinë në BE? 100 ditë sprint për Tiranën dhe 100 ditë sprint për Shqipërinë. Lipsët për secilin nga ne një kontakt për të sjellë ndryshimin", shtoi Veliaj.



Kreu i opozitës: Jo Shqipërisë së drogës dhe pastrimit të parave

Basha: Opozita fituese nëse zhvillohen zgjedhje të përgjithshme

"Nuk luftojmë për pushtet, duam qeveri për qytetarët"

Valentina Madani

Për kreun e PD-së Lulzim Basha beteja e opozitës nuk është një beteje për pushtet, por që Shqipëria të mos jetë më parajsë për trafikun e drogës dhe pastrimit të parave. Sipas tij paraja e nxjerrë nga trafiku është përdorur si në aktivitetet ekonomike, ashtu edhe në politikë. Duke cituar raportet e Europolit dhe Departamentit Amerikan të Shtetit, z.Basha akuzon qeverinë se e ka kthyer Shqipërinë në prodhuesin dhe furnizuesin kryesor të marijuanës në Europë. Në një intervistë për të përditshmen italiane "Il Fatto Quotidiano", Basha sqaroi se çfarë kërkon opozita pas djegies së mandateve. "Dua që politikanët e lidhur me krimin dhe narkotrafikun, si dhe ata që janë përfshirë në shtet-berjen e votave, të vendosen përpara drejtësisë. Dhe kjo, sigurisht, që nuk mund të ndodhë sa kohë në krye të qeverisë të jetë Edi Rama, mbrojtësi dhe garant i kryesor i kësaj gjendjeje. Prandaj, kërkojmë dorëheqjen e tij", deklaroi lideri i opozitës. Basha i ktheu përgjigje deklarimit të kryeministrit Rama sa nuk ka një revoltë popullore, por një revoltë të një opozite të dërguar në shtëpi. "Këto janë deklaratat propagandistike, tipike të liderëve autokratë, të cilët mendojnë se po flasin në emër të popullit dhe që çdo kritikë e klasifikojnë si një tentativë për t'u kthyer prapa, në të shkuarën. Në fakt, kemi të bëjmë me një pakënaqësi e mjerim masiv, i cili po mishërohet jo vetëm në protesta e revolta masive, por edhe në një fluks masiv emigrimi", deklaroi z.Basha. Në bisedë, kreu demokrat akuzon policinë se e ka përdorur gazin lotsjellës në mënyrë të pajustifikueshme. Madje ai akuzon se qëllimi është i qartë: Nuk duan që njerëzit, veçanërisht gratë dhe familjarë me fëmijë, të marrin pjesë në protesta. "Forcat e rendit e përdorën në mënyrë të rrezikshme dhe krejt të pajusti-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

THIRRJA
"Çdo qytetar, organizatë a formacion politik që ka si objektiv të çlirimin e vendit nga droga dhe krimi është i mirëpritur në frontin e bashkuar opozitar. Rama ka qenë ministër qysh më 1998-n, është lider i PS prej 14 vitesh dhe shef i qeverisë prej 6 vitesh. Nën qeverisjen e tij, Shqipëria u shndërrua në një parajsë për trafikimin e drogës dhe pastrimit e parave të pista", tha z.Basha.

Përgjimi i ri për "Babalen", PD: Balla i përfshirë në aferën kriminale

Ish-deputeti demokrat Ervin Salianji publikoi dje një tjetër përgjimeve mes drejtorit të policisë së Fierit, Albert Nushi dhe Fredi Alizotit, lidhur me dosjen "Babale". Sipas tij, dëshmitari Fredi Alizoti i janë afruar para nga zyrtarët e policisë dhe se gjithçka është koordinuar nga Taulant Balla. "Prokuroria e bën me qëllim që të fshehë emrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, të kopolës drejtuese të policisë, e përfshirë e gjitha në sajimin apo në përdorimin politik për të mbuluar aferën kriminale, apo të fshehë po ashtu edhe emrin e një zyrtari të lartë të PS, Sekretarit të Përgjithshëm të PS-së Taulant Ballës dhe përfshirjen e tij në aferën e sajimit të dëshmitarit të rremë kundër opozitës", deklaroi z.Salianji. Për LSI, përgjimet tregojnë përdorimin e policisë nga qeveria. "E gjithë policia e shtetit është vënë në shërbim të kriminit dhe interesave politike të Edi Ramës. Edi Rama ka shkatërruar policinë e shtetit duke e vënë në shërbim të kriminit të organizuar", deklaroi ish-deputeti i LSI-së Indrit Brahimllari. Për çështjen "Babalja", prokuroria ka kërkuar ndalimin e Albert Veliut, i cili në videon e publikuar prej PD është personi që ka zhvilluar bisedën për blerjen e kanabisit. Për PD-në diskutimi është bërë me vëllain e ish-ministrit Fatmir Xhafaj. Por akuzat shprehet se kallëzimi është i rremë pasi biseda zhvillohet mes Veliut dhe Alizotit.

PËRGJIMET, BISEDA MES DREJTORIT TË POLICISË SË FIERIT DHE ALIZOTIT

Nushi: O Fredi por po vij mor burrë, kalova Kolonjën, po vij
Alizoti: Ore je drejtori ti apo jo?
Nushi: Tashi, unë jam drejtori Albert Nushi
Alizoti: Ej, se dua të takoj Taulant Ballën
Nushi: Kë do takosh?
Alizoti: Taulant Ballën, o vëlla
Nushi: Ok
Nushi: Jam në një vendngjarje tani. Më thuaj çfarë do
Alizoti: Dua diçka se kam ngelur rrugëve, jam ku më le radhën e parë
Nushi: Thuaj çfarë do nga unë?
Alizoti: Do më dërgosh një njeri
Nushi: Po, po, po, do të nis aty një njeri me lekë
Alizoti: E more vesh, e do troç. E kape muhabetin

fikueshme. Gazi lotsjellës u përdor qysh në fillim prej policisë dhe jo si alternativë e fundit e mundshme. Ekzistojnë pamje që tregojnë sesi gazi lotsjellës është përdorur në mënyrë të qëllimshme nga forcat policore për të dëmtuar protestuesit. Synimi është i qartë, nuk duan që njerëzit, veçanërisht gratë dhe familjarë me fëmijë, të marrin pjesë në protesta", deklaroi z.Basha. Një shpjegim, kreu i demokratëve, e ka edhe për aleancën me LSI-në, ish-aleaten e qeverisë Rama. Sa i përket bashkëpunimit me LSI, Basha shprehet se qëllimi i të dy forcave politike është i njëjtë. "Pozicioni ynë është i qartë. Çdo qytetar, organizatë a formacion politik që ka si objektiv të vëtin çlirimin e vendit nga droga dhe krimi i organizuar është i mirëpritur të bëhet pjesë e frontit të bashkuar opozitar. Rama ka qenë ministër qysh më 1998-n, është lider i Partisë Socialiste prej 14 vitesh dhe shef i qeverisë prej 6 vitesh. Nën qeverisjen e tij, Shqipëria u shndërrua në një parajsë për trafikimin e drogës dhe pastrimit e parave të pista", theksoi z.Basha. Kreu i opozitës u shpreh i bindur se në betejën për rrezimin e pushtetit ka mbështetjen e shumicës së shqiptarëve. Madje ai theksoi se në sondazhe, Partia Demokratike do të fitojë shumicën nëse sot zhvillo-

SHKURT

Basha mbledh kolegjin e kryetarëve: Më 13 prill protesta kombëtare

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, mbledhi pasditën e djeshme kolegjin e kryetarëve në selinë blu, ku u diskutua për protestat dhe vijimin e aksionit politik. Nuk dihet nëse kryedemokrati do ta hedhë për diskutim apo marrë në konsideratë ftesën e shefit të mazhorancës Edi Rama për të shkuar në zgjedhje të parakohshme në shtator, nëse opozita futet në zgjedhjet lokale të qershorit dhe fiton një bashki më shumë se PS. Protesta e fundit e opozitës së bashkuar, por pa Bashën, u zhvillua të enjten para Kuvendit ndërsa mbahej seanca plenare. Partia Demokratike ka vendosur që të thërrasë shqiptarët sërish në një protestë të madhe kundër qeverisë dhe kjo është aktuar të mbahet më 13 prill, duke nisur nga ora 18:00. Ky vendim u mor pas mbledhjes së Këshillit të Kryetarëve. Në fuqi mbetet vendimi për protestë në çdo seancë plenare që do të zhvillohet, sikurse është bërë edhe më herët, përgjatë javëve të fundit. Protesta e fundit e opozitës së bashkuar, u zhvillua të enjten para Kuvendit ndërsa mbahej seanca plenare.

Banorët e Astirit mesazh Ramës: Ki kujdes, mos e trash zullumin

Protesta e banorëve të Unazës së re hyri dje në të 140-ën ditë në mbrojtje të banesave të tyre. Banorët i kujtuan Ramës se duhet ta harrojë që mund të vjedhë vota në Unazë, siç ka bërë në të gjithë Shqipërinë dhe se ata nuk do të lejojnë që t'u dhunohen shtëpitë dhe mudi i tyre. Ish-deputeti demokrat Klevis Balliu, komentoi fillimisht ofensivën e Ramës ndaj qytetarëve dhe medias, duke i kërkuar të mos e trashë më tej zullumin. "Pashë meetingun mjeran të Erion Veliut dhe dua t'i them që Erion po ta bëjmë me me karriqe mbaron vargu në Tropojë", tha ish-deputeti i PD-së.

Në këtë betejë besojmë se kemi edhe mbështetjen e shumicës dhe sondazhet e konfirmojnë këtë", u shpreh kreu i PD-së.

Ndërtuan në tokën e shtetit ose të të tretëve, marrin tapitë për tokën

Miratohet lista me personat që kanë ndërtuar pa leje dhe fitojnë të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqet ndërtimore. Me një vendim të veçantë, qeveria ka përcaktuar metra katrorë për parcelat ndërtimore në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë. Janë 600 përfitues në të gjithë vendin, të cilët do të marrin tapitë për truallin mbi të cilin kanë ndërtuar. Në listën e miratuar nga qeveria janë përcaktuar sipërfaqet për çdo përfitues, ndërsa ngarkohet ALUIZNI për pasqyrimin e tyre në dokumentet përkatese. Përfituesit do të mar-

Lista me 600 pronarë që u miratohet e drejta mbi truallin

Përfituesit Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë

rin tapitë për sipërfaqet e përcaktuara në VKM, pavarësisht sipërfaqes që kanë deklaruar në procesin e vetëdeklarimit të ndërtimit pa leje. Përfituesit kanë mbyllur të gjithë detyrimet dhe

pritet të marrin tapinë për tokën.

KALIMI I PRONËSISË

Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje bëhet sipas dispozitave të

Kodit Civil. Sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funk-

sion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vite për ndërtim i shiten

poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.

PRONARËT QË U MIRATOHET E DREJTA MBI TRUALLIN

DREJTORIA E ALUIZNI-T FIER			
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 3358 SH. MARINAS			
PANDEL	KRIST	LENA	522
PANDEL	KRIST	LENA	222
PANDEL	KRIST	LENA	972
PANDEL	KRIST	LENA	3278
PANDEL	KRIST	LENA	1408
PANDEL	KRIST	LENA	580
ARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8533 ZVRPP FIER			
SHEHE	SULEJM	HOTI	423.3
TAHIR	ASLLA	HETEMAJ	427
HAJROS	FERIZ	KAJOLLI	286
HAXHI	HAMIT	CAKERRI	288
BASHKI	SHYQY	ELMAZAJ	405.9
BESNI	MUSTA	MALOKU	718
HAXHI	FEJZI	FERKO	323
TAHIR	ASLLA	HETEMAJ	427
SHEHE	SULEJM	HOTI	423.3
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8532 ZVRPP FIER			
GEZIM	SELADI	DERVISHI	
ARDIA	SELADI	DERVISHI	450
MANUE	SELADI	DERVISHI	
PELLUM	MYSTEH	ALUSHAJ	307
VALENTI	KRIST	DEVJAJ	124
KOZM	KOLI	GJONI	463
NATASH	BARJA	HEBEJA	90.5
ARQIL	JOTI	DASHI	240
VIOLETA	HARED	DURAJ	43
VIKTO	LONI	MILE	70
ADMIRI	RAPI	KERRI	276
REDIA	RAPI	KERRI	
NORIS	DILAVE	DERVISHAJ	226
RAMAZA	FEJZU	GURGURI	219.8
VASIL	TODI	PRIFTI	357
JORGJ	PETRO	MERTIRI	290
ARBE	ENVER	ISUFAJ	227.8
PANDEL	DUD	KOLA	129.6
ALTIN	PANDE	MERTIRI	184
SOKRAT	LLAZI	KOLA	217.2
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 3981 ZVRPP FIER			
KRIST	RUSTE	SINASI	337
BESIM	NURE	MANAJ	374
FAIK	ALI	DRIZA	355
VLADIMI	SADIK	IDRIZAJ	331
AGUR	MYSTEH	HATJAJ	228
ALBANA	ENVER	KABASHI	258
ARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8534 ZVRPP FIER			
HASA	MEMET	ELMAZAJ	317
BASHKI	SAFET	KAMBERAJ	500
SELAM	QERIM	SALAJ	103
MYLAZI	SABRI	GASHI	354

GEZIM	SELIM	HILAJ	424
ARBE	MATO	BUDAJ	363.2
LEONA	RESMI	GEGA	359
EDMON	MTI	PJETRI	213
DILAVE	ISMAIL	SHESHALLIU	340.2
PANDEL	DHANI	GJATA	200
VANGJE	LONI	KOLA	279
LEONA	VANGJ	KOLA	
ERVIN	RAKO	SHTEMBARI	316.6
XHEVI	MUSTA	SULAJ	322
FASLLI	RAMO	ALUSHAJ	371
SHPETI	REFAT	KASA	308
THOM	PALI	NUSHI	405
LEDIO	SELAM	SALAJ	161.1
LAURET	TODI	FILIPI	
GENTIA	VILSO	FILIPI	
ENEAL	VILSO	FILIPI	300
KASTRI	TEKI	HADUSHAJ	297
ARIST	PETRI	KUQI	450
FERDIN	KAMBE	SUBASHAJ	329
AGIM	HALIL	SMAKA	222
LEONA	PETRIT	SALAJ	406
MARIGL	LILI	PIPA	221.9
MEHME	NEZET	SALIAJ	300
PETRAQ	VASIL	NAKA	331
AGRO	FANI	MONÉ	283
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 3031 ZVRPP FIER			
MIRESIJ	VELI	HATELLARI	351
SHKEN	SHABA	HOXHAI	170
SHKEN	SHABA	HOXHAI	889
FEIM	ISMAIL	BRUHUSHAJ	323
YLLI	RUSTEM	CANAJ	498
HAMIT	MUHAME	BRUHUSHAJ	308
SKENDE	XHEPO	BRUHUSHAJ	407
RAMIS	SKENDE	BRUHUSHAJ	448
THANAS	QEMAL	XHOKAXHI	411
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 1634 fshati Frakull e			
DREJTORIA E ALUIZNI-T DURRES			
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 1925, ZVRPP			
SAJMIR	JUSUF	FARRICI	400
ARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 3385, ZVRPP			
MARIGLE	GEZIM	JAHOALLARI	200
GEZIM	HYSEN	JAHOALLARI	
ARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 3542, ZVRPP			
NARDI	ZINI	HOXHA	90
FIKE	BAJRAM	HOXHA	
NARDI	ZINI	HOXHA	
FIKE	BAJRAM	HOXHA	71
ARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8518, ZVRPP			
JOLLAND	SOTIR	SHAHAJ	19
ARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8516, ZVRPP			

JANI	ANDON	COMOLLARI	138
LEFTER	ANDON	COMOLLARI	137
BUJAR	QEMAL	PAPUSHALLAJ	456
SHPRE	HAXHI	TURKU	391
ARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8514, ZVRPP			
HATE	XHEMAL	BERHOMI	
MERIT	ABDYL	BERHOMI	17
ARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8511, ZVRPP			
RITVA	AGRON	GJEVORI	
MIRJET	AVDYL	GJEVORI	410
BAJRAM	HASAN	DUNGA	522
DREJTORIA E ALUIZNI-T TIRANA RURALE			
IRANE ZONA KADASTRALE 2380, ZVRPP TIRANI			
IRANE ZONA KADASTRALE 3550, ZVRPP TIRANI			
IRANE ZONA KADASTRALE 1604, ZVRPP TIRANI			
ARJAN	FERIK	ÇULLHAJ	223.5
HAXHI	ALUSH	RRAHMANI	262.2
HAMD	MUSTA F	TOSHI	316.8
QARKU TIRANE ZONA KADASTRALE 1605, ZVRPP TIRANI			
BAJRAM	MEDI	BASHA	356.4
ASLLAN	DEMUSH		
SADRI	HYS	DARSI	350
IRANE ZONA KADASTRALE 1604			
ISLAM	BAJRA	AHMETI	293.7
IRANE ZONA KADASTRALE 2105			
MENTO	RAMAD	SHIRA	350.4
IRANE ZONA KADASTRALE 3064			
RIDVA	KAMBE	MILLOSHI	262.2
IRANE ZONA KADASTRALE 2951			
ASTRI	MERSI	CELMETA	370
IRANE ZONA KADASTRALE 2953			
ARBEN	FETAH	METKO	421.5
KUJTIM	TERXHA	LENA	492.9
AGRON	KUJTIM	LENA	
SULEJMA	DEMIR	KALAJA	419.4
IRANE ZONA KADASTRALE 3866			
RIZA	SERVET	XHEPA	264.3
SERVET	TAHIR	XHEPA	
ARTAN	SERVET	XHEPA	297
MUNIR	ISUF	PUCI	266.1
SADIK	HAJREDI	CERA	234.9
ZAMBAK	CAUSH	DINOSHI	159.3
HAJREDI	QERIM	ISTREFI	198.8
FERIT	MAN	CERA	500
IRANE ZONA KADASTRALE 3866			
LIRI	NUREDI	BARDHI	110.8
IRANE ZONA KADASTRALE 2953			
ERVIS	QEMAL	SHABANAJ	288.6
IRANE ZONA KADASTRALE 3866			
FATIME	SEID	SALLAKU	261

Qeveria miraton ndryshimet procedurat ligjore të kalimit të tokës bujqësore

Tokë me ligjin 7501, shtohen edhe tri kategori që përfitojnë tapi

Kusht mbetet regjistrimi në gjendjen civile më 1 gusht 1991



Foto ilustruese

Personat që kanë punuar në ish-ndërmarrjet bujqësore, por që nuk jetonin në fshat, personat që jetonin në fshat, por që nuk kanë punuar në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe personat që kanë marrë me qira tokë bujqësore, por ajo nuk është pjesë e investimeve strategjike do të pajisen me tapi për tokën. Kushti i vetëm që duhet të plotësojnë të tri kategoritë është që të kenë pasur regjistrimin në gjendjen civile në fshat në 1 gusht të vitit 1991. Ky është ndryshimi i fundit që ka miratuar qeveria shqiptare në lidhje me kalimin e të drejtës mbi pronësinë për tokat bujqësore. Në vendimin që është botuar në fletoren zyrtare, i cili u jep të drejtë përdoruesve të tokës të kthehen në pronarë, thuhet se "familjet bujqësore ose individët, të cilët përbushin kushtet: janë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore më 1.8.1991, gjendja civile e të cilëve u është transferuar në fshatin ku gjendet toka objekt i kalimit në pronësi, pas datës 1.8.1991, por të mos kenë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo pronësi, në fshatin ku kanë pasur gjendjen civile më 1.8.1991; që e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, por kanë mungesë në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë" thuhet në vendim. Për të marrë tapin familjet bujqësore ose individët, të cilët përbushin kushtin "nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore, por kanë qenë banorë të fshatit ku gjendet toka bujqësore, objekt i kalimit të pronësisë, sipas regjistrimit të gjendjes civile më 1.8.1991, por të mos kenë përfituar me parë tokë bujqësore në përdorim apo pronësi dhe ata persona që e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, por kanë mungesë në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë." Pronarë të tokës do të jenë edhe personat që kanë marrë me

qira, në bazë të ligjit për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ose ka kaluar në administrim të ministrisë përgjegjëse për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural, me destinacion dhënie me qira, sipas legjislativës në fuqi. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve mbyllet në datën 31 dhjetor 2019.

KALIMI I PRONËSISË

Përfitojnë kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore, subjektet që plotësojnë, njëkohësisht, këto kushte: a) Kanë qenë legjitimuar për të përfituar

tokë sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.255, datë fillim te gushtit 1991, nr.452, datë 17.10.1992, apo vendimeve të veçanta, pavarësisht nëse kanë ndryshuar vendbanimin pas datës 1.10.1992. Këtu përfshihen edhe subjektet, që, sipas informacionit të gjendjes civile, kanë ardhur me banim në territorin e ish-ndërmarrjeve bujqësore pas datës 1.8.1991 si dhe banorët jo punonjës të ish-kooperativave bujqësore; b) Nuk kanë përfituar tokë bujqësore në territorin e ndonjë kooperative apo ndërmarrjeve bujqësore tjetër; c) Përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë paraqitur kërkesë pranë organeve kompetente për plotësimin me AMTP për tokat e ish-kooperativave bujqësore

apo ish-ndërmarrjeve bujqësore ose janë pajisur me aktin e marrjes së tokës në përdorim; c) Janë përdorues faktikë të tokës bujqësore.

KRITERET

Toka që kalohet në pronësi, pa shpërblim, duhet të përmbushë, njëkohësisht, këto kushte:

- T'i përkasë një prej zërave të tokës bujqësore;
- Të mos jetë pronë private e të tretëve;
- Të mos u jetë dhënë në përdorim apo me qira të tretëve;
- Të mos jetë objekt i formave të kompensimit fizik, sipas ligjit nr.133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", të ndryshuar;
- Të mos jetë zënë nga ndërtime pa leje, të të tretëve apo të vetë subjektit kërkues;
- Të mos jetë objekt i investimeve strategjike, sipas ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë";
- Të mos jetë në përgjegjësi administrimi të institucioneve kërkimore-shkencore. Lista e këtyre pasurive vendoset në dispozicion nga ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë.

Bizneset në vështirësi financiare

Tatimet: Si mund t'i paguani detyrimet me këste

Nëse jeni në vështirësi financiare dhe nuk arrini të paguani njëherësh detyrimet që keni ndaj tatimeve, mund ta bëni me këste. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë nënshkruar me organin tatimor, një marrëveshje të pagesës me këste se mund ta ndjekin në kohë reale nëpërmjet modulit e-Filing. Në llogarinë individuale të tatimpaguesit, në menynë "Kontabilitet" shfaqet menjëherë plani i pagesës, nga ku mund të gjenerohet "Urdhër Pagesa" e dedikuar vetëm për këtë plan. Paga- sja do të mbulojë vetëm periudhën/periudhat e përcaktuara në kështin e radhës. Në rastet e marrëveshjeve për pagesë me këste, tatimpaguesi paguan kamatëvonesat, ndërsa nuk llogaritet gjë për pagesë të vonuar. Administrata Tatimore, gjithashtu, sjell në vëmendje të tatimpaguesve që përko- hësisht gjenden në situatë të vështirë financiare, se ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar, neni



77, ju jep të drejtën për të paguar me këste një detyrim tatimor të papaguar. Marrëveshja për pagesë me këste nuk mund të lidhet për detyrimin tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogarit, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Tatime të një natyre të tillë, por pa u kufizuar vetëm në to, përmenden: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Tatimi në Burim, Kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, ndonjë lloj takse e cila llogaritet, mbledhet e mbahet nga tatimpaguesi. Hapat që duhen të ndiqen për të nënshkruar një marrëveshje të pagesës me këste janë: 1.Kërkesë me shkrim drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore nën juridik-

sinion e të cilës është regjistruar (Shpjegoni rrethanat dhe arsyet pse kërkohet të lidhet një marrëveshje për të paguar me këste detyrimet tatimore. 2. Drejtoria Rajonale Tatimore brenda 10 ditëve njofton nëse kërkesa pranohet apo refuzohet. 3. Nëse kërkesa pranohet, nënshkruhet marrëveshja për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara. Kjo marrëveshje nënshkruhet nga tatimpaguesi dhe nga drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve ose drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, vetëm nëse tatimpaguesi paguan menjëherë 20% të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja e pagesës me këste. Administrata tatimore thekson se në këtë rast ndërprehet masat e mbledhjes me forcë, të mbledhjes së detyrimeve tatimore, por ajo nuk tërheq masën e vendosur për të siguruar pagesën e detyrimit tatimor. Nënshkrimi i një marrëveshjeje për pagesën me këste të një detyrimi tatimor, nuk ndërprehet llogaritjen e kamatëvonesave për mospagim në afat të detyrimit tatimor të mbetur pa paguar.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 4,000,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare" Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 15 Prill 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Arrestohet 35-vjeçari. Trajtohej me KEMP, pasi vuante nga probleme mendore

Krimi në familje trondit Gramshin, burri mbyt me duar bashkëshorten, nënë e 3 fëmijëve

Autori Alvin Hysa para hetuesve: Gruan e vrava, pasi dyshoja se më tradhtonte

GRAMSH

Një tjetër vrasje është shënuar në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Gramsh. 35-vjeçari Alvin Hysa ka mbytur me duar bashkëshorten, nënë e tre fëmijëve. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ngjarja e rëndë ku humbi jetën 32-vjeçarja Gurije Hysa ka ndodhur në fshatin Grekan të këtij rrethi. Mësohet se ngjarja ka ndodhur për motive xhelozie, pasi autori i krimit në familje dyshonte se e shoqja e tradhtonte. Sipas burimeve të mësipërme, konflikti në çift kishte nisur që prej disa muajsh. Dyshimet që kishte për gruan kanë çuar deri në marrëzi Alvin Hysën, i cili i ka futur duart në fytyrë gruas teksa ajo ishte në gjumë. Pas krimit, 35-vjeçari, i cili dyshohet se vuan nga probleme mendore ka dalë nga banesa dhe ka ikur me një mushkë të motra e tij në fshatin Lumas të Beratit. Pasi i ka treguar motrës se kishte vrarë bashkëshorten, ai është rikthyer sërish në banesë. Pasi i ka treguar motrës se kishte vrarë bashkëshorten, ai është rikthyer sërish në banesë.

oficerët e Policisë Gjyqësore, Alvin Hysa ka pranuar se ka mbytur nënën e fëmijëve të tyre, duke thënë se mes tyre kishin lindur konflikte, pasi ai dyshonte se ajo e tradhtonte. Pas kryerjes së veprimit hetimorë paraprake, hetuesit e çështjes pohan se autori i krimit rezultoi të ketë qenë njëri prej problematik dhe ushtronte dhunë sistematike ndaj bashkëshortes për shkak që lidhen me xhelozinë.



Alvin Hysa me bashkëshorten



Banesa e familjes Hysa ku ndodhi vrasja

"RRËFIMI" TE MOTRA

Dyshimi se gruaja e tradhtonte ka çuar deri në marrëzi Alvin Hysën, i cili i ka futur duart në fytyrë gruas teksa ajo ishte në gjumë. Pas krimit, 35-vjeçari, i cili dyshohet se vuan nga probleme mendore ka dalë nga banesa dhe ka ikur me një mushkë të motra e tij në fshatin Lumas të Beratit. Pasi i ka treguar motrës se kishte vrarë bashkëshorten, ai është rikthyer sërish në banesë.

Zbardhen procedurat e ndjekura edhe për nënshtetësinë

Si u bë indiani Nitin Sandesara, konsull nderi i Shqipërisë në Afrikë?



Skandali i dy vëllezërve indianë që kërkohen nga autoritetet e vendit të tyre për vjedhjen dhe pastrimin e 1 miliardë dollarëve amerikanë, përfshin institucionet më të larta në Shqipëri. Sipas mediave indiane, arrestimet e para për skandalin e "Sterling Biotech" janë kryer në nëntor të vitit 2017. Dy muaj më vonë, në janar të 2018-ës Byroja Qendrore e Hetimeve në Indi, listoi si të kërkuar dy vëllezërit, Nitin dhe Chetan Sandesara. Por edhe pse ishte në kërkim Nitin Sandesara ia doli që një muaj më pas të merrte nënshtetësinë shqiptare, përmes një procedure të veçantë, siç informoi zyra e presidentit.

"Janë zbatuar procedurat ligjore me propozimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për shkak të angazhimit për realizimin e investimeve të rëndësishme elitare në vendin tonë", thuhet në reagimin zyrtar të Presidentit. Për ministrinë e Blendi Klosit ka propozuar që dy vëllezërit

në kërkim për vjedhjen dhe pastrimin e 1 miliardë dollarëve, të pajisen me shtetësi shqiptare me argumentin se do të kryenin investime në Shqipëri. Por skandali thellohet më tej. Pas marrjes së nënshtetësisë shqiptare, Nitin Sandesara zgjidhet nga ministria e Jashtme si Konsull Nderi i Shqipërisë në Nigeri. Sipas Ceremonialit Zyrtar, konsulli i nderit emërohet me propozim të ambasades ose Ministrisë së Jashtme të vendit pritës, pra në këtë rast nga Ministria e Jashtme e Nigerisë ose ambasada

DËSHMIA E VRASËSIT

Gjatë marrjes në pyetje nga oficerët e Policisë Gjyqësore, Alvin Hysa ka pranuar se ka mbytur nënën e fëmijëve të tyre, duke thënë se mes tyre kishin lindur konflikte, pasi ai dyshonte se ajo e tradhtonte. Pas kryerjes së veprimit hetimorë paraprake, hetuesit e çështjes pohan se autori i krimit rezultoi të ketë qenë njëri prej problematik dhe ushtronte dhunë sistematike ndaj bashkëshortes për shkak që lidhen me xhelozinë.

BURG INDIANIT

Indiani Hitesh Patel që u arrestua tri ditë më parë në Rinas është lënë në burg nga Dhoma Penale e Gjykatës së Tiranës. Togat e zezë kanë vendosur ndaj tij masën e sigurisë 40 ditë qëndrim në paraburgim, pasi 59-vjeçari akuzohet për mashtrim të kredive bankare, të cilat i përfitoi përmes kompanisë "Sterling Biotech" me bazë në Indi. Hitesh Patel është kunati i vëllezërve indianë Nitin dhe Chetan Sandesara, të cilët zotërojnë grupin "Sterling Biotech group".

ganeve të rendit dhe SHISH-it për të verifikuar pastërtinë e Nitin Sandesaras, është njëra anë e skandalit. Ana tjetër është se në koordinim të përbashkët, dy ministri të qeverisë shqiptare, ajo e Turizmit, e drejtuar nga Blendi Klosi dhe ministria e Jashtme në atë kohë e drejtuar nga Ditmir Bushati, i kanë dhënë imunitet diplomatik një personi, i cili ka vjedhur 1 miliardë dollarë, një pjesë e të cilave ishin vendosur që të pastroheshin në Shqipëri. Top Channel

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbarrimore L.D.C

"Trull + ndertese" me nr. pasurije 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale, 3906, me sipërfaqe totale 300 m², regjistruar në Z.V.R.P.P. Tiranë. Çmimi filluesar për shitje është 1.900.000 Leke.

Data e shtypjes 27.02.2019

Data e zhvillimit 28.03.2019 deri në orën 16.00

Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përmbarrimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me permbarruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dyte për pasurinë:

1- Trulli, me sipërfaqe 250 m² dhe sipërfaqe ndërtese 85m², e ndodhur në Blinckë, Devoll, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 1831/50, Vol. 20, Faqe. 70. Në pronësi të Vasil Ferit Mucoku. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 5,600 (pesmije e gjashtëqind) EURO ose 700,000 (shtatëqind mijë) LEKE.

Ankandi i dyte për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 17.04.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrtës së permbarruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri", vila nr.8/1, kt.4, Tiranë, nr.kontakti 0699381883.

Shoqërohen mbi 30 persona. Avokatët bojkotojnë për 3 ditë proceset gjyqësore

Atentati mafioz në qendër të Elbasanit, kamerat filmuan ekzekutimin e avokatit

Krimet e Rënda marrin në dorë çështjen. Ja 2 pistat e hetimit për vrasjen e 50-vjeçarit Ravik Gurra

ELBASAN

Një ditë pas ekzekutimit me dy plumba pas koke të avokatit të njohur Ravik Gurra, policia ka shoqëruar dhe marrë në pyetje mbi 30 persona në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në qendër të qytetit të Elbasanit. Mësohet se mes personave të shoqëruar janë dhe pjesëtarë të fiseve në konflikte të vazhdueshme me njëri-tjetrin, Çapja e Çelaj, të cilët pas verifikimeve dhe deklarimeve janë lënë të lirë. Ndërkaq, Prokuroria për Krimet e Rënda ka marrë në dorë hetimet për vrasjen në një atentat mafioz të 50-vjeçarit Gurra. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake në lokalitetin pranë kalasë së këtij qyteti dhe pyetjes së dëshmitarëve, oficerët Krimeve të Rënda kanë ngritur edhe pistat e para hetimore për ekzekutimin e avokatit. Pista kryesore të hetimit ku është përqendruar policia, janë: Vrasje për shkak të detyrës dhe përplasjes mes bandave në qytetin e Elbasanit. Ravik Gurra 50 ka qenë avokat i fisit Çapja në Elbasan dhe avokat në procesin e Emiljano Shullazit dhe grupit të tij. Një burim i organit të akuzës pohoi për tvklan.al, se për shkak të dyshimeve paraprake që ngjarja lidhet me detyrën që ushtronte si avokat, çështja i ka kaluar për hetim Prokurorisë së Krimeve të Rënda bazuar në nenin 79/a të Kodit Penal "për vrasjen e funksionarëve publikë".

Lidhur me hetimin për këtë ngjarje, ekspertët e kriminalistikës kanë sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë në lokal. Nga burime hetimore, mësohet se është filmuar ekzekutimi i avokatit të njohur. Sipas kamerave të sigurisë, një person u afrua në tavolinën ku ndodhej i ulur 50-vjeçari së bashku me dy miq të tij (njëri prej të cilëve, ekspert i Avokatit të Popullit). Atentatori ka zbritur nga një makinë tip "Benz", e cila drejtohej nga një person i dytë. Pasi u afrua në tavolinën ku ishte ulur viktimat, ekzekutori i ka qëlluar dy herë në kokë me pistoletë me silenciator. Ravik Gurra ka humbur jetën menjëherë. Ndërsa dy miqtë që ndodheshin me të nuk kanë pësuar asnjë lëndim. Ata i dhanë policisë të gjitha informacionet e nevojshme për atë që kishin mundur të shikonin skenën e krimit dhe karakteristikat fizike të autorit. Në vendngjarje, grupi hetimor sekuestroi vetëm një gëzhgojë. Më pas, ekzekutori i avokatit Gurra u largua me automjetin që po e priste i parkuar pak metra më tutje lokalit pranë zonës së kalasë. Disa minuta më vonë, policia gjeti 7 km larg vendit të ngjarjes në zonën e Bradashshit makinën tip Mercedes-Benz të përdorur nga



Avokati i vrarë, Ravik Gurra



Vendi ku ndodhi ngjarja

autorët. Mjeti u konstatua i shkrumbuar, çka do ta bëjë më të vështirë punën e hetuesve për të mbledhur prova. Sipas burimeve poli-

core, kjo makinë e përdorur në vrasjen e avokatit Ravik Gurra rezultoi që të jetë e vjedhur në dhjetor të vitit 2018 në Fushë-Krujë. Pr-

onari i automjetit kishte bërë denonim për vjedhjen e makinës së tij. Pavarësisht hetimeve të kryera deri tani dhe kontrolleve të bëra nga

efektivët e repartit RENEA në më shumë se 20 banesa, policia ende nuk ka rënë në gjurmët e autorëve të krimit. Vrasja e avokatit ka tronditur gjithë opinionin publik. Avokatët në qytetin e Elbasanit vendosën të bojkotojnë për 3 ditë seancat gjyqësore në shenjë proteste për vrasjen e kolegut të tyre. Ndërkohë, për ekzekutimin e avokatit ish-

ÇFARË THOTË NENI 79/A:

"Vrasja e funksionarëve publikë (Shtuar me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013) Vrasja me dashje e deputetit, gjyqarit, prokurorit, avokatit, ushtarakut apo e funksionarëve të tjerë publikë, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm".

të njoftuar zyrtarisht edhe ambasada britanike në Tiranë, pasi Ravik Gurra prej më shumë se 8 vitesh ishte shtetas britanik. Viktima me shtetësi angleze bënte jetë me Shqipërisë dhe Anglisë. Ai jetonte me nënën e tij në Elbasan, ndërkohë që ka dy vajza.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 27 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 27.03.2019 (përfshirë TVSh-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOUNGE (6MG) 100 DSP 20 SSL	200 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar'" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani, Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10, 1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670



'5 vrasje në 7 ditë', ish-kryeministri Sali Berisha: Shqipëria si Afganistani

TIRANË - Ish-kryeministri Sali Berisha shprehet se Shqipëria është kthyer si Afganistani, pasi në 7 ditët e fundit janë bërë 5 vrasje. Në një postim në "Facebook", ai thotë se java me 5 të vrarë u mbyll "me Kongresin e suksesit të partisë së pushtetit të krimit".

POSTIMI I BERISHËS:

5 të vrarë në 7 ditë në Shqipëri! 3 në gjithë Europën pa Shqipërinë! Ngushëllime të ndërra për familjet e tyre. Miq, Shqipëria sot mund të krahasohet vetëm me Afganistanin ose Libinë. Ajo mbyllti javën me pothuaj dyfishin e të vrarëve të të gjithë Europës. Në dy raste vrasësit u dorëzuan vetë, ndërsa në tre rastet e tjera ata u larguan në drejtim të paditur se kishin punë, ishin delegatë në kongresin e suksesit të partisë së sojt të tyre. Kurse narko-policia mori nga reanimacioni madje me serum për në komisarariat protestuesin armik.

Java me 5 të vrarë u mbyll me kongresin e suksesit të partisë së pushtetit të krimit. Suksesese! Sb

HRUSHOVI NDIKIMI NE TIRANE

Historia e panjohur e raportit sekret të Kongresit të XX-të të Bashkimit Sovjetik që tronditi edhe Enver Hoxhën dhe si ra ai në dorë të amerikanëve...?!

Konferenca e Tiranës që tronditi Enver Hoxhën pas Kongresit të XX-të në Moskë

Enveri, ky mjeshtër i madh i lojës së dyfishtë, ende nuk e kish ndarë mendjen se me kë do të ishte: Me Stalinin e balsamosur, apo me Hrushovin, liderin e gjallë

Spartak Topollaj

(vijon nga numri i kaluar)

HRUSHOVI DREJT MAJËS SË PUSHTETIT, PASI ELIMINON BERIAN

Ashtu si pa u ndjerë, Hrushovi filloi t'i lëvizë fijet e padukshme deri te kapilarët e partisë (që urrenin gjarpërinjtë e Sigurimit) për të hapur rrugën drejt majës së pushtetit. Kjo duhej bërë shpejt dhe pa humbur kohë, përpara se "Qeni i Kuq", siç thirrej Beria, të mund të kafshonte. Dhe këtu ai s'kish sesi të mos siguronte përkrahjen e shumicës së Presidiumit 14-të anëtarësh e kandidatësh, përfshi dhe dy nga "kuajt" e Trojkës, Malenkovit dhe Molotovit, të cilët e njihnin mirë su-perkriminelin e djallëzuar dhe kryeintrigantit gjeorgjian, këtë kameleon të paklasifikueshëm. Për të realizuar skemën e tij, Hrushovi thirri në ndihmë Zhukovin, Marshallin "bonapartist", siç e quajti më vonë dhe zëvendësin e Berias, Serovin, që gjithashtu për 1001 arsye i trembej dhe e urrente shefin e tij. Beria arrestohet nga këta të dy, gjykohej dhe ekzekutohej në fshehtësi të plotë, siç kish bërë vetë më parë me një numër pa fund drejtuesish të të gjithë niveleve, pa mundur ta gëzojë Vitin e Ri 1954. Bashkë me atë, të njëjtin fat pësuan, tre nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të tij Merkulov, Rjumini dhe Abakhumov.

REFORMAT DHE POLITIKA LIBERALE PAS KONGRESIT TË XX-TË

Tani udhëheqja e re, ku hynë edhe Zhukovi e Serovi, e pati më të lehtë marrjen e masave dhe reformave të guximshme në të gjithë sektorët, jo vetëm duke anuluar shumë nga vendimet dhe metodat represive e drastike të kohës së Stalinin, por edhe ndryshimet menjëherëshme për përmirësimin e jetesës së popullit dhe fillimin gradual të liberalizimit të shoqërisë, si edhe u bënë ndryshime të dukshme në politikën e jashtme, si armëpushimi në Kore, shtensionimi i marrëdhënive me Jugosllavinë e Titos, me vendet e Perëndimit e sidomos me SHBA-



në. Në shtator 1953, Hrushovi zgjidhet edhe de jure Sekretar i Parë i KQ dhe nga kjo pozitë, sulmoi, kritikoi ashpër, e ngarkoi me përgjegjësi për gabime të rënda Malenkovin, duke emëruar Bulganinin në vend të tij në krye të Qeverisë Sovjetike. Shumë ministra të shkarkuar, mbetën megjithatë të kënaqur, teksa u dekretuan ambasadorë, ndërsa vetë Molotovi i shpëtoi përkohësisht kësaj dallge që po merrte përpara një kastë të tërë stalinistësh.

Në këto rrethana, nga 14-26 shkurt 1956, u mbajt në Kremlin i famshmi Kongres i XX-të i PKBS, me praninë e 1436 delegatëve të përzgjedhur me kujdes personalisht nga Hrushovi dhe bashkëpunëtorët më të besueshëm të tij (1356 me votë deliberative dhe 80 me votë konsultative). Ky Kongres, pa mëdyshje historik, me raportin sekret të Hrushovit, ku sundimi i Stalinin u quajt tirani dhe u denoncau ashpër e pa doreza kultit i tij i individit, tronditi rëndë komunizmin botëror dhe veçanërisht, vendet ku regjimet komuniste ishin në pushtet! Që në seancën inauguruese, çliruar nga fantazma e Stalinin, me fjalën hyrëse që zgjati 5 orë, Hrushovi nuk eštë se s'e befasoi dhe tronditi sallën, pavarësisht përzgjedhjes së delegatëve apo pjesëmarrjes së 55 delegacioneve të huaja komuniste, ku spikaste Mao Ce Duni, Ho Shi Mini, Kim Ir Seni, Dezhi, Vilhem Piku, Torezi, Toliati, Ibaruri, etj pa lënë mën-

janë në fund Enver Hoxhën. Për të parën herë u pranua si alternativë fitorja e socializmit pa revolucion, me rrugë parlamentare, pra me votë demokratike dhe u hodh teza e bashkë-ekzistencës paqësore mes dy blloqeve të mëdha. Për shmangien e çdo situatë jo normale dhe zbardhjen e ndonjë paqartësie, shërbeu ndërhyrja e Mikojanit, i cili foli hapur për gabimet e rënda të Stalinin në politikën e jashtme dhe përmendi shumë nga personalitetet e partisë dhe të shtetit të ekzekutuar pa asnjë faj në vitet '30-të!

RAPORTI SEKRET NË KONGRES ME KRIMET E PËRBINDSHME TË STALIN-IT

Më datën 24 shkurt, u zgjodh K.Q. i ri me 133 anëtarë dhe 122 kandidatë, ndërkohë që delegatët u ftuan të marrin pjesë të nesër-

men në një seancë me dyer të mbyllura, në të cilën u mbajt dhe i famshmi raport sekret i N. S. Hrushovit: Mbi kultin e individit dhe pasojat e tij. Që më 1955 ishte ngritur një Komision me në krye Sekretarin e K.Q., Pospjellov për verifikimin e të gjithë krimeve, fajeve, gabimeve dhe përgjegjësisë të epokës staliniste. Më 9 shkurt 1956, Komisioni paraqiti para Presidiumit materialin tronditës të përgatitur, me miratimin e Hrushovit dhe Shepilovit, material i cili, u vendos t'i paraqitej Kongresit, pavarësisht kundërshtimit të treshes Kaganoviç, Voroshillov, Molotov. Raporti sekret i paraqitur në Kongres mëngjesin e 25 Shkurtit nga Hrushovi, shokoi sallën e Madhe të Kremlinin. Stalin, denoncohej, fajësohej, akuzohej dhe dënohej rëndë, si shkakhtar i të gjithë të këqijave, por jo



vetë Partia?! Stalini u akuzua jo vetëm për eliminimet e tmerrshme të udhëheqësve të Partisë, Shtetit dhe Ushtrisë, në vitet '30-të, por sidomos për mungesën e përgatitjes, përballimit dhe komandimit të Ushtrisë së Kuqe në dy vitet e para të Luftës së Dytë Botërore, kur edhe ajo pësoi humbjet më të rënda. E pafalshme për Hrushovin ishte mospërmendja e Masakrës së Katinit ndaj 22.000 oficerëve robër polakë në mars të 1940-të, kryer nga Beria pas urdhrin të Stalinin, zbuluar nga ushtria gjermane më 1943, që dhe ish akuzuar si autore e Masakrës, e fshehtë që u zbardh vetëm pas vitit 1990, e që nuk lehtëson dhe përgjegjësinë e aleatëve anglo-amerikanë, që ishin në dijeni të së vërtetës. Nga ana tjetër, Hrushovi heshti dhe për farsat gjyqësore dhe ekzekutimet, ndaj disa prej udhëheqësve në vendet e Demokracive Popullore, siç quheshin aso kohe, vendet e Europës Lindore. Kështu Slanski, Rajku, Kostovi dhe Xoxe u mashtruan për "interes" të Partisë dhe Socializmit, duke iu premtuar falja e jetës, edhe pse "pranonin" fajësinë si agjentë imperialisto-titistë, dhe u ekzekutuan pa mëshirë. (Natyrishat ata kishin bërë krime dhe e meritonin dënimin, por krimet e tyre u bënë me dijeninë, miratimin dhe urdhrat stalinistë të udhëheqësve në vendet e tyre respektive, siç qe rasti i Koçi Xoxes, i cili kur kuptoi mashtrimin në seancën e fundit farsë të gjyqit, deklaroi: "Qofsha bir kurve, po fola më, pasi çdo krim është bërë me dijeninë, miratimin dhe urdhrin e Komandantit"! Si e përmendëm më sipër, mes 55 delegacioneve të huaja që morën pjesë në Kongresin e XX të PK të BS, ishte dhe ai i PPSH-së, kryesuar personalisht nga Enver Hoxha. Si e përjetoi ai këtë atmosferë të acartë të destalinizimit, në Moskën e Shkurtit 1956, ç'mendonte dhe ç'plane ogurzeza projektonte dhe thurte ai për të ruajtur, mbajtur, konsoliduar e përjetësuar sundimin despotik të tij? Hipokrit, kameleon, intrigant, prapakanist klasi, siç edhe ishte ai, Enveri po përगतit Kongresin e III të Partisë, por para saj ishte Konferenca e Tiranës (Prill 1956), por për këto dhe ngjarje të



tjera të mëdha, si vizita e çuditshme, enigmatike e plot mistere e Hrushovit në Shqipëri, do të bëjmë fjalë në pjesën e tretë të këtij shkrimi.

SI E ZBULOI RAPORTIN E FSHEHTË GAZETARI HEBREO-POLAK, VIKTOR GRAJEVSKI?!

Në një numër të reduktuar kopjes, nën siglën TOP SECRET, të nesërmen e mbajtjes, Raporti me kapakë të kuq, iu shpërnda të gjithë krerëve të delegacioneve dhe Sekretarëve të Parë të të gjitha Partive Komuniste, pra kuptohet edhe Enver Hoxhës. Interesant mbetet fakti se si u bë e mundur që, në vend të shërbimeve të fuqishme inteligjente, aq të interesuara për ta shtënë në dorë atë, raporti u sigurua prej një gazetari të ri e mjaft të pashëm hebreo-polak, 32-vjeçarit Viktor Grajevski, (ndryshe Viktor Shpilman), kryeredaktor i PAP (Agjencia Polake e Lajmeve), e dashura e të cilit, Luçia Baranovski, sekretare e Eduard Ohabit, kreut të Partisë së Shtetit polak, në prag divorci me bashkëshortin, zv/kryeministrin e vendit, e pakujdesshme dhe e turbulluar nga pasioni, e kish lënë librin mbi tavolinën e zyrës?! Ai iu lut asaj nëse mund t'i hidhte një sy raportit, por ajo për hir të dashurisë ia ofroi atë ta lexonte të tërin, me kusht që t'ia kthehte deri në orën katër të pasdites, se duhej mbyllur në kasafortë. Pas një hezitimi të shkurtër, gazetari u nis drejt ambasadës izraelite, ku në fillim e pritën ftohtë, madje me skepticizëm dhe mosbesim, por shpejt e kuptuan se çfarë u kish rënë në dorë dhe sakaq e foto-filmuan. Më 5 qershor, raportin të plotë e publikoi The New York Times?! Duket e pabesueshme, por ky raport, për herë të parë u publikua i plotë në Bashkimin Sovjetik të Gorbacovit, vetëm më 1989, nga gazeta Izvestia!?



nojak, në disa prej librave të tij të viteve të fundit, si p.sh. "Hrushovi Gënjën", justifikon krimet e tmerrshme të Stalinit, madje edhe e ekzaltton figurën monstruoze të tij! Le ta ilustrojmë lajthitjen e këtij "profesori", vetëm me një fakt: nga 139 anëtarët dhe kandidatët e K.Q. të PKBS, zgjedhur nga Kongresi i XVII, 98 prej tyre ose 70% u arrestuan dhe u ekzekutuan, ndërsa nga 1966 delegatët pjesëmarrës në Kongres, 1108 prej tyre patën të njëjtin fat të zi!

KONFERENCA E TIRANËS QË TRONDITI ENVERIN

Enver Hoxha që e përjetoi gjithçka ndodhi drejtpërsëdrejti, madje dhe e përshëndeti Kongresin, kthehet në Tiranë plot dilema për vijën që tani e tutje do të ndiqte PPSH-ja, e cila po përparonte për Kongresin e saj të Tretë. Ndërkohë në rrethe, para Kongresit pritjet të zhvilloheshin edhe Konferencat e Partisë, të cilat ajo e Tiranës, prill 1956, jo vetëm befasi por edhe e tronditi Politbryonë dhe vetë Enverin me frymën e saj të ngjashme me atë të Kongresit të XX. Enver Hoxha, ky mjeshtër i madh i lojës së dyfishtë, ende nuk e kish ndarë mend-

jen se me kë do të ishte: Me Stalinin e balsamosur në mauzoleum pranë Leninit në sarkofag xhami, poshtë mureve të Kremllinit në Sheshin e Kuq, apo me Hrushovin, liderin e gjallë sovjetik, zyra e të cilit ndodhej vetëm disa metra më tej...?! Po t'i referohemi kujtimeve të kryesekretarit personal të diktatorit tonë, apo si quhej ndryshe Shef i Sektorit të Përgjithshëm, Haxhi Kroit, këtij burokrati unik, që mund ta quajmë edhe ROLEX-i i Enverit, Komandanti pushtonte gjatë, sa në Karlovi Vari, aq edhe në Soçi e Sukhumi, sa në Drilon, aq edhe në Vlorë, apo Dajti (madje Nexhmije Hoxha nuk lejoi botimin e tyre, pasi dilte që Enveri, tërë jetën në shumë kish-të pushuar se sa kish punuar)! Kështu, teksa pushonte për shtatë palë qefje në rezidencën e tij në Ujë të Ftohtë, mori një telefonatë shumë shqetësuese nga Beqir Baluku, i deleguari i K.Q. në Konferencë, i cili e njoftoi mbi situatën e rëndë të krijuar nga diskutimet e forta dhe pyetjet e shumta drejtuar udhëheqjes, prej një numri të madh delegatësh, mbi shkeljet e abuzimit e Bllokut në luks, ndërsa populli vuan me mungesën e ushqimeve, që ishin me triska, mung-

esën e vendeve të punës, strehim-it, veshjeve dhe mallrave të domoshme, gjendjen e mjerueshme në fshat, burgosjet, internimet, etj. I kthyer me urgjencën më të madhe, ai hyri si i tërbuar në sallë, që me urdhër të tij tashmë ishte rrethuar nga forca të shumta të Sigurimit dhe Policisë. I informuar më së miri për zhvillimet në Konferencë, ai sulmoi egërsisht diskutantët disidentë, madje duke i etiketuar si të nxitur e frymëzuar nga Legata Jugosllave?! U arrestuan dhjetëra delegatë, disa prej të cilëve si Liri Gega ish-anëtare e Byrosë Politike, Gjeneral Dali Ndreu (bashkëshort i saj), kolonel Petro Bullati (kunat i Vasil Shantos), etj u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan me shpejtësi si agjentë të Beogradit!

HHRUSHOVI I KËRKUJTI ENVERIT TË MOSË PUSHKATONTE LIRI GEGËN

Hrushovi iu lut Enverit, të paktën t'i kursehej jeta Lirisë të të majshe shtatzënë por ai, si rëndom, nuk pati asnjë pikë mëshirë?! Kongresi i III-të i PPSH u mbajt nga 25 maj deri më 3 qershor 1956. Ai ishte kongres hipokrizie dhe dyfytërsie i Hoxhës, çka vërtetohet nga fakti se materialet e tij, u botuan disa herë në versione të ndryshme dhe në varësi të koniukturave politike dhe kalkulimeve djallëzore të tij.

Revolta e parë e armatosur ndaj një regjimi komunist të pas Luftës së Dytë është ajo në Shqipëri, që njihet si Revolta e Koplikut e 1945, por Bota njeh si revoltë të para ato të shpërthyer në RDGJ, më pas në Poznan, Poloni dhe si kulm Revolucionin Demokratik të Tetorit 1956 në Hungari, të shtypur me tanket sovjetike të Hrushovit, sipas një skenari të Juri Andropovit, ambasador sovjetik i kohës në Budapest, më pas Shef i KGB-së dhe në fund kreu i Partisë dhe Shtetit Sovjetik pas Brezhnjevit (1982-1984). Në këtë periudhë udhëheqja sovjetike përfshihet nga ethet e një gare, të ashtuquajtur paqësore, për ta arritur e madje edhe për t'ia kaluar SHBA në të gjitha fushat, ndërkohë që Lufta e Ftohtë vazhdonte, sovjetikët hodhën në orbitën e Tokës edhe satelitin e parë SPUTNIK (Bashkudhëtar) më 4 tetor 1957, i cili pasi përshkoi 70.000.000 km, ra i djegur. Në delirin e madhësishtë deri të krijimi i njëriut të ri sovjetik, Hrushovi urdhëroi hedhjen në orbitë të SPUTNIK 2, kësaj here me një qenie të gjallë brenda, vetëm një muaj pas të parit, në prag të 40 Vjetorit të Revolucionit Bolshevik, më 3 nëntor 1957. Mes tre qenve u përzgjedh LAJKA, që mbijetoi vetëm shtatë ditë, ky program i sputnikëve, që vepër e shkencëtarit Sergej Koroljev. Shkrimtari Jarosllav Gollovanov në Librin "Kozmonauti Nr.1", tregon se në të vërtetë raketa e parë me dy qentë Dezik dhe Cigan ishte ngritur që më 1951 deri 100 km. dhe pas 15 minutash kishin bërë ulje me parashutë. Por njeriu i parë që fluturoi në orbitën e Tokës me VOSTOK 3 KA-3 dhe u kthye si hero, ishte Juri Gagarin më 12 prill 1961, i thirrur me humor "xhuxhi gjigand", nga që ishte vetëm 157 cm i lartë, i cili pati një fund tragjik më 27 mars 1968, teksa avioni që pilotonte u rrezua dhe u dogj bashkë me të. Pas tij, kozmonautë të shquar ishin German Titov dhe Valentina Tereshkova. Tani ishte rradha e amerikanëve që garën, si ata atletët e distancave të gjata, s'e

nisën me sprint, por vrapuan të sigurtë drejt kozmosit duke ulur njeriun e parë në Hënë. Kjo ndodhi më 20 Korrik të 1969 kur "APOLLO 11" u ul pas 385.000 km. rrugë mbi sipërfaqen e të vetmit trup qiellor, satelitit i Tokës, me astronautët Neil Armstrong, Michael Collins dhe Buzz Aldrin.

KOMPROMISI I ENVERIT ME HHRUSHOVIN NË 1957-ËN

Në nëntor të 1957 në Moskë u mbajt Mbledhja e Partive Komuniste të Botës, në të cilën nuk mund të mungonte PPSH dhe kreu i saj Enver Hoxha. I ndodhur mes dilemash të shumta dhe pothuaj i vetëm (PKK dhe Mao Ce-Duni ende nuk dilnin haptazi kundër Hrushovit) ndjeu rrezikun e spostimit nga pushteti, si po ndodhte në shumë vende komuniste në frymën e Kongresit të XX-të të PKBS, me krerët e Partive apo Shteteve respektive, ai vendosi të bëjë një kompromis të përkohshëm me Hrushovin, nisur edhe nga gjendja reale shumë e rëndë ekonomike e vendit dhe nevoja jetike për ndihmë sovjetike dhe vende të tjera socialiste për realizimin e Planit të Dytë Pesëvjeçar. Deklarata përfundimtare e Mbledhjes së Moskës, vetëm sa e konfirmoi kompromisin, që zgjati de facto edhe tre vite dhe de jure edhe katër të tillë. Duhet thënë, se Hrushovi ishte i pari që bëri shkrirjen e akujve stalinistë dhe Informbryoristë të 1948-ës me Titon, teksa vizitoi Jugosllavinë e u takua me Titon më 1955 (me vetë kishte edhe Bulganinin). Hoxhës nuk kish si t'i pëlqente kjo, pasi nga një servil i neveritshëm i Titos, deri më 1948-ën, ai ishte shndërruar në një armik i betuar i tij me nxitjen e më të fortit, Baba Stalinit! Në të vërtetë ishin të "deleguarit" e Titos, Miladini e Dushani, ata që e kishin sjellë Hoxhën në krye të Partisë e më pas edhe të Qeverisë. Në një akt të turpshëm, të paprecedent dhe të pafalshëm, në korrikun e 1946-ës, gjatë vizitës dy javore të Enverit në Jugosllavi, ky i fundit pranoi të poshtërohej nga Marshalli deri aty, saqë edhe pse brodi e gjezdisi gjithë Federatën, nuk u lejua të vizitonin, as edhe një minutë të vetme Kosovën shqiptare! Nga ana tjetër, edhe vetë Tito, që s'ia vend të Botës pa shtetiu, nuk denjoi kurrë ta vizitonte fqinjin jugor, Shqipërinë! Hrushovi bëri disa përpjekje ta pajtonte Enverin me Titon dhe arriti në një farë mënyre ta bënte përkohësisht këtë. Por aty nga fundi i '57-ës e fillimi i '58-ës, Hrushovi u ftoh me Titon, që nuk pranoi tërheqjen prapa nga qëndrimet e Kongresit të XX-të ndaj Stalinit në Deklaratën e Moskës. Kjo e detyroi Hrushovin të pohonte se paskësh patur të drejtë Stalini, madje ai, fill pas vizitës në Shqipëri e përcjelljes nga Hoxha e Shehu në aeroport, shkarkoi nga detyra e Ministrisë të Mbrojtjes dhe anëtarit të fuqishëm të Byrosë Politike, Marshallin Zhukov, i vetmi i dekoruar katër herë, hero i Bashimit Sovjetik. Në vitet 1956-'59-të Hoxha vizitoi gati të gjitha vendet e ashtuquajtura të demokracive popullore, e më së shumti vetë BS, ku pati rast që qëndroi edhe deri dy muaj, ashtu si dhe e kundërta që lider të shumtë komunistë vizituan Shqipërinë. Në këtë klimë të krijuar, Enveri mendoi se nuk duhej humbur rasti të realizohej vizita e premtuar disa herë e Liderit sovjetik, N S. Hrushovit në Shqipëri.

(vijon)

LIBRI

"Stenda bosh në Lajpcig? Ministria e Kulturës nuk shet libra"

Letërsia shqipe është e pranishme në Panairin e Librit në Lajpcig nga data 21 deri 24 mars. Ka pasur një program takimesh të organizuara në stendën e Ministrisë së Kulturës, në stendën e rrjetit TRADUKI si dhe në hapësira të tjera të panairit dhe jashtë tij. Në Lajpcig janë të pranishëm edhe dy autorë të ftuar nga Ministria e Kulturës Lisandri Kola dhe Saimir Muzhaka e dy autore e përkthyesve të ftuara nga rrjeti TRADUKI dhe rezidenca e përkthyesve në Berlin Lindita Arapi dhe Anrila Spahia (Ana Kove).

Por në imazhet e publikuara nga vetë Ministria e Kulturës në faqen e saj zyrtare, stenda e Shqipërisë shihet bosh, çka ka nxitur edhe kritikën.

Mimoza Hysa, drejtore e librit në Ministrinë e Kulturës ka shkruar në profilin e saj në rrjetin social 'Facebook' se "për mungesën e librave në stendën e Shqipërisë: së pari, Ministria e Kulturës nuk ka të drejtë të shesë libra; së dyti, vetëm ekspozimi i librave në gjuhën shqipe në një panair në Gjermani nuk ka kuptim dhe është vetëm për të mbushur raftet; së treti, çka rëndësi se me çfarë koncepti shkohet në panair". Sipas Hysës, MK-ja po përpjetet të bëjë një punë mbështetëse për prezantimin dinjitoz dhe përfshirjen e autorëve shqiptarë në program me autorët e huaj përmes rrjetit TRADUKI, si dhe hartimin e katalogut të autoreve me skedën e librit në gjuhën angleze, gjë që përbën punën bazë për të tërhequr vëmendjen për autorët tanë nga shtepitë e huaja botuese. "Kjo është mënyra profesionale për t'u paraqitur në një panair, jo mbushja e raftëve për soditje. Në panair shkohet për të tërhequr vëmendjen e botuesve të huaj, jo për të falur disa libra shqip pesë lexuesve shqiptarë që mund të rastisin aty. Së fundmi, për ata që nuk i njohin autorët e paraqitur në stendë dhe në katalog, janë thjesht fituesit e çmimeve më të rëndësishme të vitit të kaluar: nëse nuk janë të informuar është



Sqarimi i drejtoreshës për panairin në Gjermani dhe një takim për përkthimin

problemi i tyre. Dhe një këshillë për të rinjtë që duan të bëjnë emër në këtë fushë: emri bëhet me punë jo me sulme vend e pa vend", e ka mbyllur Hysa sqarimin e saj.

Gjatë këtyre ditëve janë mbajtur diskutime në stendën e Traduki-t me autorët Saimir Muzhaka, Aleksandar Spatov, Christiani Witter, me temën "Në jetën time private jam më i mirë se kaq" moderuar nga Annemarie Türk. Brenda katër mureve të tu ndonjëherë ndeshesh me diçka të pamundur. Të papritur. Rizbulon vetveten dhe ambientin rreth teje. Në tregimin e Alexander Spatov "Ditëlindja e nënës sime në Mladost Dy" (botuar në librin me tregime "Një mik i huaj", Shtëpia Botuese Eta 2018) një bir bullgar, për herë të parë, sheh prindërit e tij me një sy të tjetër. Protagonistja - një vajzë e re - e Christiani Witters tek "Në jetën private jam shumë më mirë se kaq", merr shumë këshilla nga gjyshi i saj. Ndërsa tregimi i Saimir Muzhakës "I harruari" nderon nënën dhe babain e tij të harruar.

PËRKTHIMI

Ndërsa përkthimi, ish-të diskutimit në stendën e Shqipërisë dhe me autorët dhe përkthyesit Lisandri Kola, Ana Kove dhe Mimoza Hysa.

Letrat shqipe kanë një traditë të pasur përkthimi nga gjuha e huaj, por kanë vështirësi të kalojnë letërsinë shqipe në gjuhë të huaja. Ku qëndron thebi i kësaj marrëdhënie të vështirë? A ka shkaqe të brendshme, përveç atyre të mungesës së përkthyesve të huaj të interesuar për gjuhën shqipe, mungesës së agjencive letrare private në Shqipëri apo një pune mbështetëse nga shtepitë botuese që botojnë letërsi shqipe? Cilat janë politikat mbështetëse për

përkthimin e letërsisë shqipe? Mimoza Hysa e hapi takimin duke prezantuar katalogun në gjuhën angleze të letërsisë shqipe në Panairin e Librit në Leipzig, në të cilin përveç autorëve fitues të çmimeve të vitit të kaluar janë përfshirë dhe dy përkthyeset Ani Gjika dhe Evelyn Noygust, të dyja finalistet për çmimet e përkthimit në dy vendet respektive të veprave të përkthyer, në Amerikë dhe Francë, gjë që dëshmon raste suksesi të rëndësishme të përkthimit të letërsisë shqipe dhe futjes në tregun e huaj të librit. Nisur nga krijimtaria e Lisandri Kolës ku gjuha dhe identiteti që

Për Lisandri Kolën varianti i gegërishtes në përkthim mbart të njëjtat vështirësi si çdo gjuhë tjetër. Dëshmi është përkthimi i suksesshëm i shumë autorëve që shkruajnë në këtë variant, për të përmendur një me shkallë vështirësie të lartë si Martin Camaj.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me Përmbartues Gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. "Ibrahim Rruova", Pallati 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 03.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i për shiten e pasurisë së paluajtshme. Ndërtëse me sipërfaqe totale 186 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Shkodër me Nr.pasurie 2/613+1-6, Volumi 37, Faqe 232, Zona Kadastrale Nr. 8591 në pronësi të Z.Alfred Lec.Mazi me vlerë fillestare në ankand 100.000 (njëqind mijë) EURO.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com;

"Një këshillë për të rinjtë që duan të bëjnë emër në këtë fushë: emri bëhet me punë jo me sulme vend e pa vend"

mbërthehet në të është "strajca me rrënjë" apo "kryqi" që mban mbi shpinë, u shtrua pyetja sa humbet poezia dhe proza e tij nga përkthimi, sidomos po të merret parasysh përdorimi i variantit të gegërishtes në tekstet e tij. Për Lisandri Kolën varianti i gegërishtes në përkthim mbart të njëjtat vështirësi si çdo gjuhë tjetër. Dëshmi është përkthimi i suksesshëm i shumë autorëve që shkruajnë në këtë variant, për të përmendur një me shkallë vështirësie të lartë si Martin Camaj. Ana Kove si shumë autorë shqiptarë ka nisur ta përkthejë vetë poezinë e saj në gjuhën gjermane gjë që e bën më të lirë përkthimin, duke e

"Në panair shkohet për të tërhequr vëmendjen e botuesve të huaj, jo për të falur disa libra shqip pesë lexuesve shqiptarë që mund të rastisin aty"

rikrijuar.

Pyetjes nëse letërsia shqipe ka prurje të rëndësishme që meritojnë të përkthehen në gjuhë të huaj, Lisandri Kola, në rolin e studiuesit të letërsisë shqipe, iu përgjigj se letërsia shqipe është në një fazë tranzicioni estetik dhe, me gjithë prurjet e shumta ku nuk mungojnë vepra të rëndësishme, mbetet ende në kërkim të identitetit të vet në rrafshin estetik. Me pas më konkretisht u diskutua rreth mungesave të strukturave të qëndrueshme për përcjelljen e letërsisë shqipe në gjuhë të huaj: si mungesa e përkthyesve të huaj të interesuar për letërsinë shqipe, gjë që kërkon edhe politika mbështetëse. Hapja e fondit të mbështetjes së përkthimit nga gjuha shqipe të mundësuar nga Ministria e Kulturës ka ndihmuar që në tre vite 16 vepra të përkthehen nga gjuha shqipe, por është e rëndësishme që nisimat e mira të mos jenë sporadike, por të qëndrueshme. Për Lisandri Kolën ngritja e një sistemi nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me Ministrinë e Kulturës. Rasti i rrjetit TRADUKI që përbën një shembull suksesi në këtë drejtim dëshmon se strukturat e qëndrueshme janë ndërthurje faktorësh të ndryshëm.

Ana Kove mbyll takimin me leximin e poezisë së saj të përkthyer në gjuhën gjermane.

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ankandin e trette të pasurisë të palës debitorë Sh "ARNI" sh.p.k dhe hipotekuesve P Goxhaj dhe M Goxhaj, Pasuria që del në ankand të trette përbëhet nga:

"Apartment", me Nr pasurie 69/11/ND +1-14 ndodhur ne Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati i 3 Ap 14, Onikum e regjistruar ne ZV.RFP- Vlore, Z.K.Nr.2832, volumi 16, faqe 120.

Ankandi do të zhvillohet në datë 10.04.2019 në orën 15:00 në selinë Buj "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakt 067 2082543 e-mail ilir_dervishaj@yahoo.com faqen WEB www.powerjustice-al.com.

E DIEL

24 Mars

2019



Për herë të parë

Samii Frashëri "i zakonshëm" me sytë e vajzës së tij, Samijes

NGA HIKMET FERIDUN ES
DHE KUJTIM NURO

Një nga shkrimet e para, ku studiuesit Turq të periudhës së viteve 40-60, të shekullit XX- të si Agah Sirri Levend, Hikmet Dizdaroglu, Omer Faruk Akun etj., dhe deri në ditët e sotme lidhur me historinë e jetës personale të Samii Frashërit, përveç kujtimeve të shkruara prej tij, të djalit Ali Samii Yenit, e miqve dhe të bashkëkohësve janë

mbështetur dhe mbështeten dhe në kujtimet e hollësishme të vajzës së tij të madhe, Samijes. Këto kujtime, të cilat deri me sot janë dhënë në mënyrë fragmentare nga studiuesit e lartpërmendur në studimet e tyre, janë botuar në disa numra të gazetës "Aksam" (Aksham-K.N.) gjatë periudhës : 20 Dhjetor 1944 - 4 Janar 1945, nga gazetari i mirënjohur Turk, Hikmet Feridun Es (1909-1992). Ai i ka përfshirë kujtimet e vajzës së Samiut, në vazhdimësinë e botimit të shkrimeve në seri në faqet e gazetës "Aksham" lidhur me jetën dhe veprimtarinë e njerëzve më të shquar, të cilët kishin dhënë një ndihmesë të

madhe në përparimin dhe civilizimin e Turqisë, por që në krahasim me veprën e madhe që kishin lënë, jeta e tyre personale ishte mjaft pak e njohur nga lexuesit i gjere dhe veçanërisht nga studiuesit e fushave të ndryshme të shkencës. Shkrimet e botuara nga Hikmet Feridun Es në këtë gazetë, janë përfshirë dhe në librin me të njëjtin titull: "Njerëzit e famshëm që nuk i njohim", botuar nga Shtëpia botuese "Otuken Nesriyat", Stamboll, 2009. Ai, në serinë e këtyre shkrimeve, duke u mbështetur në kujtesën e familjarëve, të bashkëshorteve, fëmijëve, nipërve, mbështetësve dhe të miqve të tyre të

afërm, jep mjaft të dhëna të hollësishme dhe me interes nga jeta personale e personaliteteve të mëdha Turke. Hikmet Feridun Es është përpjekur të marrë të dhëna të hollësishme nga jeta personale e Ahmet Vefik Pashes, Besim Omer Pashes Haxhi Arifit, Husejin Rahmiut, Kemal Pashazadese, Lejla Hanemit, Marko Pashes, Mit'hat Pashes, Mizanci Muratit, Muallim Nacit, Nigar Hanit, Osman Hamdiut, Sulejman Numanit, Tevfik Fikretit etj. Në mesin e këtyre personaliteteve, ndodhet dhe enciklopedisti, dramaturgu, gjuhtari, romancieri, përkthyesi, i rrallë për të gjitha kohërat, Samii Frashëri,

apo Shemseddin Samii, siç njihet në historiografinë Turke. Kujtimet e botuara nga gazetari i talentuar, i kemi gjetur në Arkivin e Taha Toros, i cili ndodhet pranë bibliotekës së Universitetit të qytetit të Stambollit. Arkivi i koleksionistit të rrallë Turk përmban 400.000 dosje, ku një pjesë të rëndësishme e përbëjnë dokumentet, fotografitë, kupurat e gazetave, shënimet e tij lidhur me historinë e territoreve dhe personalitetet shqiptare gjatë Perandorisë Osmane dhe me tej.

→ Vijnë në faqen 14

Në këtë numër: OLGA CARLISLE PËR PASTËRNAK, KUJTIM NURO DHE HIKMET FERIDUN ES, KOSTANDIN RISTANI, AD DEVOLLI NGA A. MEKSI, QERIM VRIONI ETJ...

D

DOKUMENT

NGA KUJTIM NURU

Vijon nga faqja 13


Prandaj koleksioni i arkivit të Taha Toros, një pjesë e të cilit, Universiteti i Qytetit të Stambollit e ka dicializuar, është njëkohsisht dhe një burim i rendesishëm arkivor jo vetëm për historianet Turq, por dhe për studiuesit e Shqipërisë. Lidhur me shërbimin e madh që Taha Toros i ka bërë dhe historiografinë Shqiptare, nepermjet grumbullimit të një numri të shumë dokumentesh, do t'i kushtojmë ne shenjë mirënjohjeje një shkrim të vecantë. Gazetari Hikmet Feridun Es, e cili dhe ai ka një meritë të vecantë, duke u mbështetur në kujtimet e Samijes, përshkruan ngjarje nga jeta e perditshme e dijetarit të madh të dy kulturave asaj Shqiptare dhe Turke, të Sami Frasherit. Keto kujtime kanë lënë gjurmë të paharruara në kujtesën e femijeve të tij, dhe vecanerisht, të vajzës së madhe, Samijes, e cila i ka qendruar gjithmonë pranë babait të saj, Samiut. Ajo ka qenë e martuar me Reshat Erenin, i cili ka qenë në kabinetin e Tefvik Pashes në detyrën e Ministrit të Financave, Arsimi dhe Vakufëve. Nga kjo martesë e tyre, ata kanë patur dy djem: Mehmet dhe Emin Erenin. Emin Ereni ka dhënë një ndihmë të madhe në pasurimin e fondit arkivor të gjuhës të tij me dokumente të reja, fond i cili ndodhet në Arkivin Qendror të Shtetit. Ai ka ndërruar jetë në Stamboll me 13 Tetor 1992. Duhet të kujtojmë gjithashtu se Samija, motra e Ali Sami Yenit se bashku me nënen e Asim Tefvik Sonmut, Ayshe Hacer kanë qepur me dorë dhe uniformën e parë të klubit të futbollit GallataSaray, të cilit se bashku me shoket e tjerë e themeluan në shkollën "Sultaniye", në Stamboll, ditën e hënë me 30 Tetor 1905. Njëkohsisht, emrin e saj e ka trashëguar dhe një nga stermbesat e Samiut. Ashtu sic thekson gazetari Hikmet Feridun Es se kur ai i ka marrë kujtimet e saj, ajo ka qenë në moshën 60 vjeçare, dhe kujtesën e saj e krahason me kujtesën e një vajze 20-vjeçare. Në rrefimet e saj, ajo thekson se babai, Samiu ishte i semurë dhe i varfër, nën dritën e qiririt, i vetëm, krijoi vepra të mëdha, sikur të ishte një Akademi e tere e Shkencave e perkushtuar ndaj historisë dhe kulturës së qyteterimit njerezor. Por, femijet e "Babait të enciklopedistëve", sic do ta therrisnin me vone studiuesit Turq, mbas vdekjes së tij, dolën nga shtëpia, për shkak të borxheve që ai nuk kishte mundur të shlyente. Pronari Fehmi Pasha, i cili morri shtëpinë e Sami Frasherit, për arsye të mos pagimit të ketyre borxheve të mbetura, u kishte lënë femijeve të tij vetëm 24 ore për të dalë nga shtëpia. Femijet, me fu mbushur afati, dolën nga shtëpia dhe i grumbulluan rrobat që kishin përpara avlisë së xhamisë. Ata, aty përjashta, me sytë e tyre të deshpëruar dhe plot lot, shikonin se si një pasha i pasur po hynte në shtëpinë e dijetarit të madh, por në një gjendje varferie. Biblioteka e Samiut prej 20 mijë vëllimesh, mbasi ndërroi jete, u shiti vetëm 80 lira. Gaze-

Autori është një nga osmanologët më të mirë në vend me një kontribut të jashtëzakonshëm. Në këtë kontribut të tij, kemi punimin mbi një shkrim botuar nga gazetari i mirënjohur turk Hikmet Feridun Es, në gazetën "Aksham"(Stamboll), Dhjetor 1944-Janar 1945 me titull: Personalitetet e famshme që nuk i njohim- Shemseddin Samiu - Një gjigand mendimtari, të cilin nuk e njohim aspak (Arkivi i Taha Toros - Universiteti i Qytetit të Stambollit). Ne kemi vendosur ta botojmë në dy numra për shkak që të ruajmë të plotë të gjithë strukturën e tij...

Sami Frashëri në kujtimet e vajzës së tij, Samijes

tari Hikmet Feridun Es ve në dukje se Sami Frashëri kishte shumë shokë të ditur të kultures islame, por nga pikpamja e besimit fetar ai ishte ndare nga ata perfundimisht, edhe pse fjala e fundit që ai ka thënë kur ndërroi jete, ishte fjala "Allah"(Perendi). Samiu bente një jete mjaft të thjeshtë, por zemren e kishte shumë të madhe. Edhe pse në gjendje jot e mire ekonomike, ai priste dhe përcillte me mjaft bujari miq, shokë, edhe pse jo në disa raste edhe grupe-grupe. Cdo të merkure, në shtëpinë ku banonte, ai e kishte bërë zakon të takohet dhe të bisedonte me miqtë dhe shoket e tij me të afert, edhe pse në trupin e tij kishte disa semundje. Gazetari Hikmet Feridun Es, duke u mbështetur në kujtimet e vajzës, do të theksojë se veshjen e dijetarit të kohës, Samiu do ta mbante që në moshë të vogël. Rrobat dhe kepuçet e tij 10-15 vjeçare do të dukeshin të reja, sepse ai dilte rrallë nga shtëpia. Ishte shumë i vemedshëm ndaj të tjerëve dhe mjaft tolerant në bisedit me shoket e tij, por kerkonte një getesi absolute, kur shkruante. Cdo ditë, i cili e fillonte punën përpara se të lindte dielli. Seria e shkrimeve të gazetarit Hikmet Feridun Es, në gazetën " Aksham" përmban titullin kryesor: "Njerezit e famshëm që nuk i njohim". Kujtimet e botuara, për të terhequr vemendjen e lexuesit, janë shoqëruar nga gazetari i lartepërmendur, përveç titullit kryesor dhe me nentituj dhe shënime të pëmbledhura. Nën titullin " Njerezit e famshëm që nuk i njohim", në përshkrimin e jetës së perditshme, dhe të veprimtarisë krijuese se Sami Frasherit, ai, botimin e kujtimeve të vajzës së madhe, Samijes, e fillon shkrimin me nën titullin:

Një gjigand mendimtari, të cilin nuk e njohim aspak : Shemseddin Samiu. Dhe me poshtë, Hikmet Feridun Es nenvizon: Samiu nuk e donte llampën me gaz. Të gjitha veprat e tij i ka shkruar nën dritën e qiririt. Në jetën e tij, llampa me gaz nuk ka hyrë në shtëpi. Qirinjtë vinin arka-arka. Minderi, ku ai rrinte, kishte ngjyre të kuqe. Fillonte të shkruante përpara se të lindte dielli. Leter me ngjyre të kalter dhe boje, e cila nuk përhapej, Mbasi shkrimi, konjak dhe çaj. Mos merrni pelhurin e dhomes.



i shiti ato vetëm për 80 lira. Punoj 16 vjet, ditë dhe natë për pergatitjen e Enciklopedisë dhe mundi të marrë nga kjo, vetëm 300 lira. Ali Sami Yenit, i GalataSarayit të njohur, është djali i tij. Kongreset gjuhësore, veprat në fushën e gjuhësive, kishin vendosur të mbanin si baze kryesore të burimeve, veprat e Samiut. Në anketën e një letrari, Ismail Habib, ka thënë: Punoj, që nuk kanë bërë shkencetaret për 40-50 vite të tera, e ka bërë vetëm Sami Frashëri duke punuar si një gjigant dhe ia ka dalë me sukses. Në bibliotekat tona, mbi tavolinat tona, në duart tona për t'u

dhënë pergjigje pyetjeve të vesh-tiresive tona, akoma që qendrojnë, janë veprat e tij. Shumica e ketyre librave që i kalon mbi 40-të, si nga lloji i tyre, të cilat cilesohen si vepra kryesore, janë punime të një pune madhesh-tore, të cilave në u drejtohem i atyre në cdo kohë. Kane kaluar shpejt 40 vjet nga vdekja e Samiut, e ketij gjigandi të madh mendimi, veprat e të cilit, që rradhiten në rrafet, ndodhen në planet me të para të bibliotekave. Ato janë veprat me më vlerë. C'fare dime për jetën, stilin e punës, idealet, gezimet e tij, vecanerisht për jetën e tij në shtëpi, për romanet, enderrimet e tij,

Si punonte ai?!

Një gjigand mendimtari, të cilin nuk e njohim aspak : Shemseddin Samiu. Dhe me poshtë, Hikmet Feridun Es nenvizon: Samiu nuk e donte llampën me gaz. Të gjitha veprat e tij i ka shkruar nën dritën e qiririt. Në jetën e tij, llampa me gaz nuk ka hyrë në shtëpi. Qirinjtë vinin arka-arka. Minderi, ku ai rrinte, kishte ngjyre të kuqe. Fillonte të shkruante përpara se të lindte dielli. Leter me ngjyre të kalter dhe boje, e cila nuk përhapej. Mbasi shkrimi, konjak dhe çaj. Mos merrni pelhurin e dhomes.

të cilat janë lene në hije. Ky është një person i madh, ndaj të cilit në kemi bërë një gabim të madh, i cili nuk i falet shkencës së vendit, që në emer të diturise, në nuk e njohin ate. Nga ana jone do të pyetet një nga një për cdo gjë të ketij njeriu, veprat e të cilit janë vepra kryesore në jetën e mendimit Turq. Në lidhje me kete, në kemi indetifikuar me një kujdes të perppikte, të gjitha detajet personale, që nga harrësa e zjarrit deri në gjerat me më vlerë të tij. Une i degjova ato nga njerezit me të afert të Samiut, sidomos nga vajza e tij me e madhe, me emrin Samije Eren. Megjithese, ajo është në moshën 60-vjeçare, kujtesa e saj që mban, është plotesisht e një moshë 20 vjeçare. Zonja Eren, që është një trashëgimtare ndaj shumë pasurive shpirtërore, që nga miresjllja deri në të dhenat e gjuhës që ka perdorur babai i saj, pati miresinë të me jape një sere të dhenash të pakrah-sueshme me mjaft vlerë lidhur me Samiun. Për moshën që ajo ka, une gjeta keshtu, romanin e jetës së tij. Sot, une nuk mund të gjeja njeri tjetër, të cilin e njihje me mirë ate në të gjitha anet për shkak se ajo nuk iu nda babait të saj për më tepër se 20 vjet.

NËN DRITËN E QIRIRIT, NJERIU, I CILI ZBULOI GJITHËSINË

Ishte një mengjes përpara 50 vjetësh. Pothuajse kishte mjaft kohë që të lindte dielli. Brenda ertësire që kishte mbuluar gjithë Er-enkoy-in, Cadde Bostan, gjithë se-cilli ishte në gjumin e tij të embel. Kishte vetëm një dritë të zbehtë në dhomen përpara, e cila ndodhe në katin e dytë të shtëpisë. Kjo shtëpi ishte plotesisht perballë xhamisë së Cadde Bostan-it. Ajo është shtëpia e Sami Frasherit, dhoma e Sami Frasherit, dhe Sami Frashëri, i cili punon. Ky është zakoni i tij i pandërprere gjatë gjithë jetës. Deri sa të kishte lindur dielli, ai shkruante shkrimet e tij, i redaktonte ato dhe pasi i dergonte në shtypshkronje, shtrihet perseri. Tani, për të parë me nga afer ku ai shkruante, le të hyjmë deri në dhomen e tij. Në shtëpi nuk ka zhurmë, nuk degjohet asgjë, sepse Sami Frasherin nuk e ka shqetesuar asnjëri. Në qoftese hapni ngadale deren e dhomes në katin e dytë, në fillim nuk keni për të mundur të shihni asgjë, vetëm grumbuj-grumbuj librash. Hidhni sytë tuaj dhe do t'u dale një koke madhesh-tore, terheqese, me një mjekër të gjatë dhe krejt të bardhë. Gjithash-tudo të degjoni gervishtjen e lehtë të një pene. Në mure, hijet e dritës së qiririt, të cilat shfaqeshin në menyrenë të vazhdueshme, vecaner-isht, hija e një koke të madhe, të rregullt, hija e një mjekre të gjatë. Ketu perballimi me ceshtjet e para të Sa-

A

ARGUMENT

NGA ARBEN MEKSI

Si të gjithë artistët e tjerë, Ad Devolli jeton talentin e tij, si një njeri i përkushtuar dhe pasionant në atë që ai krijon. Në art ai e njeh mjaft mirë kuptimin e lirisë dhe e di që për të arritur atë, duhet mjaft përkushtim.

Me një krijimtari të gjerë, të veçantë dhe cilësore me një talent vetjak por edhe të trashëguar, ai është sot një nga personalitetet e artit tonë pamor bashkëkohor.

Vizioni i tij për pikturën e tejkalon kohën që jetojmë. Ai nxjerr vlera artistike dhe me tema të thjeshta, që artistit të tjerë vëshirojnë të guxonin t'i pikturonin. Këto tema janë sa personale po aq edhe universale.

Po të vesh re punët e tij duken më të mëdha se sa janë në realitet, këtë e bën drita që ato mbartin në vetvete, sepse ai e di se në art drita është esenca e pikturës dhe forma është arkitektura e saj.

Adi është një njeri i lirë, pa paragjykimë i drejtpërdrejtë, shpërthyes, ekspresiv, po pa humbur sensin e masës, dhe mbi të gjitha Adi është njëri i butë, tepër njerëzor, përherë në kërkim të rregullit dhe harmonisë. Ai e ka të qartë se në art nuk mbahen mend ata që kanë bërë shumë, por ata që kanë bërë saktë. Arti është mjaft selektiv, kërkon cilësi, është kjo

Adi ka arritur këtë nivel në sajë të talentit dhe kulturës së gjerë, fal pasionit për historinë, letërsinë, muzikën, njohës i mirë i artit botëror, të hershëm dhe bashkëkohor. Shumë i kujdesshëm në kompozim, shpërndarjen e njollave, kontrastin, grafikën dhe trasparençen. Ai nuk ka frikë edhe pse disa tema i përsërit në forma të ndryshme sepse edhe Brenda të njëjtës teme në shohim diversitet në teknike në forme dhe ngjyre.

Për artin e Ad Devollit



arsyeja që ai punët i mban gjatë në mendje dhe në dorë.

Adi ka arritur këtë nivel në sajë të talentit dhe Kulturës së gjerë, fal pasionit për historinë, letërsinë, muzikën, njohës i mirë i artit botëror, të hershëm dhe bashkëkohor. Shumë i kujdesshëm në kompozim, shpërndarjen e njollave, kontrastin, grafikën dhe trasparençen. Ai nuk ka frikë edhe pse disa tema i përsërit në forma të ndryshme sepse edhe Brenda të njëjtës teme në shohim diversitet në teknike në forme dhe ngjyre.

Paleta e tij është potenciale e pasur në ngjyra por edhe shumë në harmoni, puna e tij nuk kërcet ajo është e lëmuar, e butë, e kurbëzuar, e kadiftë, duket sikur nuk



është punuar me penel.

Në telajon e tij përzihet imagjinata dhe emocioni duke na u shfaqur në forme, në ngjyre dhe në teknika të ndryshme pastel, vaj, laps, akrilik me kontraste grafike. Sot nuk është e lehtë të besh art të mire. Shija e publikut është e rafinuuar. Por artisti duhet të shfaqet



sepse njerëzit nuk mund të gjykojnë për atë që ke në mendje por për atë që ti i paraqet publikut. Artistët përgjithësisht janë vetmitar ta jetojnë me pasionin e tyre. Jo me kot Bukovski ka vargun e famshëm "O zot me jep një talent dhe lere të me vras". Prandaj artistët nuk duhet rreshtim se

foluri mire për punën e njëri tjetrit, se mundimet dhe gëzimet janë të njëjta. Aq me tepër tani në ekonominë e tregut.

Në galerinë "Kalo, kohet e fundit janë hapur shumë ekspozita cilësore me artistë të njohur si Gaz Leka, Ilir Pojani, Fatmir Thaçi, Leon Cika e shumë të tjerë piktorë dhe skulptorë elitare.

Kjo galeri u ka bërë nder artistëve duke ju venë në dispozicion hapësirat e saj intime dhe plotë dritë, por edhe artistët ja kanë rritur emrin dhe vlerat e kësaj galerie të vogël në dimensionet por tepër të ngrohta dhe njerëzore.

Natyrisht ekonomia e tregut i ka çekulibruar përkohësisht lidhjet direkte me artin, si të atij që e krijon edhe të atij që e shijon.

Prandaj disa artistë ndihen në pozita jo të favorshme, sepse është ulur kërkesa për krijimtarinë shpirtërore dhe artistike. Por kjo nuk do të zgjasë shumë. Kërkesa për art cilësor do të kthehet në tregun artistik.

Ekspozita e Ad Devollit është një tjetër stad në rrugën e tij krijuese, duke e evidentuar atë edhe njëherë si një nga piktorët me të rëndësishëm të brezit të tij. Ju falenderoj të gjithë ju që merrni pjesë.

miut. Ai gjatë neteve ka përgatitur nenin driten e qiririt të gjitha veprat e tij. Nen lllamben e gazit, nuk ka shkruar asnjë rresht. Lllamba e gazit ishte "tersi" me i madh për te. Nen driten e qiririt, ai krijoi botën e shkencës. E urrënte, dritën e llambes, llamben dhe eren e gazit të saj. Per kohen, dhe pse ishte periudha me e ndritshme e llabave të gazit, dhe Sami Frasheri ishte një nga njerëzit më perparimtare, në jetën e tij, llamba e gazit nuk ka hyrë në shtëpinë e tij që ndodhej në Cadde Bostan. Ne vend të kesaj, në shtëpi vinin qirinjtë të cdo lloji, arka- arka.

ULEJ NE MINDER, LETREN E MBESHTESTE NE GJUNJE

Le të shohim akoma me mire tani në anet tona driten e qiririt, mbasi zgjojme plotësisht sytë tane. Samiu ulej në një minder, i cili kishte madhësinë që mund të ulej vetem një person, duke të kujtuar një divan të vogël. Kolltuku i tij i punës kishte disa gjera specifike. Ai ishte i harkuar dhe ishte i mbuluar me një cope ngjyre vishnje. Ulej mbi kolltuk dhe shpinën, kurrrizin nuk e mbesh-teste në asnjë vend. Punonte vazhdimisht në një pozicion të perkulur. Letren e kthente nga njëra ane dhe e mbesh-teste mbi gjunjë. Ai gjithashtu, në të njetën kohë u drejtohej shumë librave . Per kete kishte bërë një tavoline me një plan perseri të vehtin, në një menyre të vecante. Kjo ishte një tavoline e vecante, mjaft e gjate, sirtaret e se cilës zgjatshin kur hapeshin me terheqje të ndryshme. Mbi të qendronin hapur libra në gjuhe të vecanta, ndonjehere në 6-7 gjuhe të ndryshme, të cilët do t'iu duhej t'i shikonte dhe t'iu drejtohej. Kjo tavoline ishte tek vajza e mad-



he dhe e ruan ate, ashtu sic ka qene. Zonja Samije Erer, e cila ndodhet perballë tavolines thote: Per librat që ai do të lexonte, kjo tavoline nuk ishte e mjaftueshme. Ne mes të grumbujve të librave, të cilët lartsoheshin në cdo cep të dhomes, ai vehte se tij i kishte caktuar një vend, një fole. Ne kete ambient, duke kaluar permes cepave të ketjre grumbujve librash qendronte duke punuar trupit i tij mjaft i lehte. Ne kohen që ju hyni në

dhome, ju nuk mund të shikoni ate nga poshte qafes. Dhe akoma me tepër, në hapin e pare ju do të ndjeni një aromë të vecante. Kjo aromë do të ishte "era e librit", e cila do të godiste menjehere hunden tuaj. Zonja Samije Erer, me sytë e saj të kredhur në mendime dhe të vrejtur duke pare tavolinen, në të cilën Samiu ka kaluar perballë saj të gjithë jetën e tij, shton: Tani, me të hapur një liber të vjeter, me

te ndjere aromen e nje libri, eshte nje-soj sikur une ndiejë eren e babaït tim.

TRE LLOJ NGJYRASH BOJE. MBAS SHKRIMIT ÇAJ ME KONJAK

Ne të dy anet e tavolines, ndodheshin dy mbesh-teste vendosese. Dhe në keto, qendronin letrat e dijetarit, doreshkrimet, boja, pena. Drita, vazhdimisht, vinte nga mbrapa. Per kete, ai kishte bërë rafte të posacem për të vendosur qiririn. Ne raftin, i cili ndodhej mbrapa, qendronte një shandan trekendror. Kurse në mbesh-testet, në secilin prej tyre, ishte vendosur një qiri. Dijetari, simbas nevojës, i terhiqte nga atje - ketu, djathtas - majtas. Simbas nevojës, shkante në tavolinen për të hapur librat voluminoze me trashësi të madhe. Vendosijen e qirinjve e kishte bërë në ta e menyre, qete kryqezoheshin në të njetën kohë me syrin e tij. Vazhdimisht, shkruante në leter me madhësi të gjate dhe ngjyre blu të erret, jo të hapur. Pjeset anesore të letres, gjithmone i perthyente, dhe i linte bosh për të bërë korrigjimet dhe shtesat e tjera të mevonshme. Rregullisht, në shkrimet e tij perdorte vetem bojen e zeze. Mirepo në veprat me tre tekste, për të mos i ngaterruar ato me njëri - tjetrin, perdorte trej lloj ngjyrash, të kuqe, blu dhe jeshile. Mirepo ngjyren blu të letres, duke mos e patur një detyrim të madh, nuk e ndryshoi. Në gjithë jetën e tij, ka perdorur letren me kete ngjyre dhe do të shkruante me pene. Pnenen e tij, do ta pergatiste me një kujdeste vecante, perpara se të fillonte të shkruante. E perthyente, i jepte asaj njëre në form të holle dhe të trashë. Ndiente kenaqësi nga perthyerja e

penes. Shishja e bojes perbeheje nga qelqi, e cila ishte në ate forme, që po të permysej, boja nuk derdhej dhe ishte nga lloji me i lire. Te gjitha veprat e tij me të njohura, ai ka shkruar me pnenen, e cila futej në shishe dhe kishte pesë lekë. Ne kohen që punonte, nuk do të futej asnjëri në dhomen e tij. Mirepo, me të mbaruar punën, ai bente dicka të vecante. Kur mbaronte dhe korrigjimet, menjehere, perplaste të here duart me njëra tjetren. Kjo perplasje tre here e duarve ishte e vetmja shenje, i cili therriste vajzen e madhe, Samijen Ererin. Ajo ndodhej në dhomen, ngjitur me ate të Samiut. Me të degjuar zhurmen e duarve tre here, vajza e re fluturonte nga krevati, dhe e djersitur, neqofese ishte, do të vraponte pranë babaït të saj, në dhomen e tij të punes. Ja në kete kohë, do të ishin oret me të mira të babaït të saj me vajzen e re, e cila kishte ngelur pa nene që në moshen gjashte vjecare. Sami Frasheri, nga mesi librave, do ta ngrinte ate duke kapur kembet e saj në ate moshe mjaft të re. Trupi i tij ishte shumë i gjate dhe delikat, me mjeker të bardhe si debora. Nen driten e qiririt, do të ngjante me një luan të dobet. Babaï kishte një zakon të rëndësishëm në oret e ketij mengjezi: Te pergatiste një ponc, të cilin e bente vehte me konjak, limon dhe çaj. Cajin, patjetër e ziente me doren e tij. Babaï e pintu kete çaj, filxhan mbas filxhani. Samiu tregonte mjaft tregime të bukura. Pastaj, vajza e re Samije, duke thene : Babaxhem: -Perendia të dhente qetes-i, do të dilte nga dhoma, sepse dijetari i madh , mbasi dergonte doreshkrimet, perseri sh-trihej për të fjetur.

Vijon

P

PERSONAZH

Intervistuesja e shkrimtarit të njohur ishte një publiciste e njohur me origjinë ruse, e cila ka jetuar jashtë vendit të saj të origjinës. Në pjesën e parë të takimit të Carlisle me Pastërnakun, autorin e njohur të "Doktor Zhivagos", po japim përshkrimin që i bën ajo takimit shumë mbresëlënës me Nobelistin e njohur rus për Paris Review

BORIS PASTËRÑAK

Si jetonte 'babai' i "Doktor Zhivagos"

NGA OLGA CARLISLE*

Më një janar, vendosa ta vizitoja Boris Pastërnakun, dhjetë ditë pasi kisha mbërritur në Moskë. Kisha dëgjuar shumë për të nga prindërit, që e kishin njohur para shumë vjetësh dhe i doja shumë poemat e tij, që i njihja prej viteve të mia të fëmijërisë.

Kisha edhe disa porosi dhe dhuratat të vogla me vete për t'ia çuar nga prindërit dhe nga disa admirues të tjerë. Por Pastërnaku s'kishte telefon dhe këtë e zbulova vetëm në Moskë. I përzura mendimet për të bërë një shkrim të plotë, ku do të kishte dhe një shënim i cili do të ishte jo aq personal për shkrimtarin. Frikësohesha, së pari, duke marrë parasysh pikëpamjen e madhësisë së korrespondencës së tij, se ai mund të kishte përpunuar ndonjë lloj forme shmangie standarde të kërkesave të shumta që i bëheshin për ta vizituar. Befas vendosa një gjë të madhe... do t'i shkoja pa e njoftuar fare këtë njeri kaq të famshëm. Së dyti, frikësohesha se Pastërnaku në vitet e mëvonshme nuk do më mbeste në imagjinatë, ashtu si më vinin natyrshëm poetitë e tij (lirikat), impulse të tëra që më hovnin prej fëmijërie.

Prindërit më kishin përmendur se kur e kishin parë Pastërnakun më 1957, pak kohë para se të merrte Çmimin Nobel, ai mbante të hapur zakonisht shtëpinë ditën e dielë-në fakt element i cili përbënte një traditë të njohur në mes shkrimtarëve rusë dhe që ruhej si zakon i tyre edhe kur ata ishin jashtë Rusisë. Kur kisha qenë adoleshente në Paris, prindërit më morën njëherë të takoja shkrimtarin Reizov dhe filozofin e famshëm Berdyayev, pikërisht në mbrëmjet e të dielës.

Të dielën time të dytë në Moskë, papritur vendosa të shkoja tek ai në Peredelkino. Ishte një ditë e shkëlqyeshme dhe në qendrën e qytetit, ku po qëndronim, bora e freskët shndritte përkundrejt kupolave të arta të Kremllinit. Rrugëve ishin derdhur vizitorë apo familjarë, të cilët kishin mbërritur që nga rrethinat dhe ashtu të mbledhur në mënyrën e tyre të zakonshme fshatareske, ecnin në drejtim të Kremllinit. Shumë s'ishte mbanin tufa me mizozë të freskëta-që konsiderohej ende një modë e njohur e asaj kohe. Në fakt, në të dielën e dimrit, mbërrinin anije të tëra me mizozë në Moskë. Rusët i blinin ato për t'ia dhuruar njërit-tjetrit ose thjesht për t'i mbajtur



për të shënuar solemnitetin e ditës.

Vendosa të merrja një taksi për në Peredelkino, megjithëse e dija mirë se një tren elektrik që vinte nga Stacioni i Trenit të Kievit afër rrethinave të Moskës, afrohej deri aty afër. Papritmas më kapi një si ngut i madh për të shkuar, paçka se e kisha parashikuar edhe kohën e shkuar dëm e që lidhej me atë që moskovicët e njihnin fare mirë dhe që përbënte pakënaqësinë e zakonshme të Pastërnakut për të pritur të huajt. Isha përgatitur thjesht t'i jepja porositë dhe pasi t'i shtrëngoja dorën të kthehesha rishitas pas.

Shoferi i taksisë, një djalë i ri që nuk ngjante fare me taksistët e tjerë përreth, më siguroi se e njihje shumë mirë Peredelkino. Dhe, që ishte gati rreth tridhjetë kilometra jashtë autostradës së Kievit. Paga sa do të ishte rreth tridhjetë rubla (3 dollarë). Ai dukesh se po e gjente kaq natyrshëm drejtimin sa që mua hera-herës më vinte të dilja dhe të shëtisja pak jashtë në këtë ditë kaq të mrekullueshme me diell.

Por, pretendimi i shoferit se e njihje mirë rrugën, qëllori të ishte një mburrje e kotë sepse shumë shpejt e humbëm drejtimin. Kishim udhëtuar me një bajagi shpejtësi përgjatë autostradës me katër korsi, pastruar jo vetëm nga bora por edhe nga billboard-ët apo stacionet e karburantit. Nga ana tjetër, kishite fare pak sinjalistike në rrugët që po përshkonin dhe ato nuk po na dërgonin drejt Peredelkino, këshutëqë ndaloniin kudo, ku kishim mundësi të hasnim dikë, e ta pyesim për drejtimin. Çdokush ishte miqësor dhe dëshironte të na ndihje, por dukej qartë se askush nuk e dinte fare se nga binte Peredelkino. Ne vozitëm për një

Për përshkrimin

"Po", tha ai "Jam në djepin të këtij interesi dhe jam jashtëzakonisht i gëzuar dhe krenar për të. Kam marrë jashtëzakonisht shumë letra, e të gjithë ato më kërkonin t'u përgjigjesha, por atëherë ishte e detyrueshme të mbaje lidhjet përtej kufijve. Ndërsa për përshkrimin e "Doktor Zhivagos", nuk mund t'i fajesoj kaq shumë. Nuk është gabimi i tyre. Ata kanë përdorur, ashtu si bëjnë kudo përshkrimet, të cilët mundohen të riprodhojnë në mënyrë fjalë-për-fjalë sesa të përgjigjen për tonin e veprës, bash nga ajo që thuhet dhe natyrisht që është edhe toni i vërtetë i çështjeve. Aktualisht, lloji i vetëm i interesit tim mbetet ai klasik. Ka dhe punë të ndryshueshme në një vepër. Për aq sa ka të bëjë sot çështja me shkrimin modern, rrallë më duket se shpërblehet përshkrimi, megjithëse mund të jetë më i lehtë. Ju po më thoni se jeni piktor. Mirë, përshkrimi është pak a shumë si të kopjosësh një pikturë. Imagjinoni veten të jeni duke kopjuar Malevich; nuk do ishte e mërzitshme?

kohë të madhe në një rrugë të gjatë të ngrirë dhe pa trotuares përmes fushave pafundësisht të bardha. Përfundimisht, u futëm në një fshat që dukej se i takonte një epoke krejt tjetër, e në kontrast të plotë me apartamentet pafundësisht të reja në rrethinat e Moskës-këto ishin të ulëta, shtëpi të stërjetra me trarë, të cilat kufizonin një si rrugë

të drejtë që kalonte në mes. Një saje që tërhiqej nga kuajt dhe disa gra me shami ishin mbledhur para derës së një kishe druri. Morëm vesh se ishin në një vendndodhje fare afër Peredelkino. Pas dhjetë minutash duke ecur në një rrugë ku nuk pushonte një erë e lehtë e përmes një gjelbërimit të përherëshëm, isha mu përpara shtëpisë së Pastërnakut. Kisha parë fotografi të tij në revista dhe papritmas, ajo u shfaq e gjallë në të djathtën time; kafe, në ballinë disa dritare me ndarje, të cilat qëndronin në një pjerrësi përkundrejt një sfondi me bredha, e cila shikonte mbi rrugën nga e cila ne aksidentalisht ishim futur në qytet.

Peredelkino është një qytet i vendosur shumë afër Moskës me pamje shumë mikpritëse dhe i gëzueshëm në të tilla mesdita me diell. Me aq sa di unë, shumë shkrimtarë dhe artistë jetojnë aty për të gjithë jetën në shtëpitë e siguruar nga shteti dhe, madje tutje ndodhet edhe një shtëpi e madhe pushimi për shkrimtarët dhe gazetarët, e cila menaxhohet nga Bashkimi i Shkrimtarëve Sovjetikë. Por pjesë të tëra të qytetit ende i takojnë artizanëve të vegjël dhe fshatarëve edhe pse nuk ka asgjë "artistike" në atë atmosferën e tyre të zakonshme.

Chukovsky, kritiku i famshëm letrar dhe shkrimtari i librave për fëmijë, jeton aty mes kolegëve të tjerë, në një shtëpi komode dhe mikpritëse, rrethuar me libra. Madje, drejton një bibliotekë të vogël të dashur për fëmijët e qytetës. Constantin Fedin, një nga shkrimtarët më të njohur që janë gjallë në Rusi, jeton në derën ngjitur Pastërnakut. Ai është tani sekretari i përgjithshëm i Unionit të Shkrimtarëve, një post që deri më tani i takonte Aleksandër Fadeev, që gjithashtu jetonte këtu deri sa vdiq më 1956. Më vonë, Pasternaku më tregoi dhe shtëpinë e Isaac Babel, në kohën kur ai u arrestua në vitin 1930 dhe nga ku nuk u kthye më kurrë.

Shtëpia e Pastërnakut është në një nga rrugët e lakuruara të qytetës, të cilat të drejtojnë poshtë kodrës drejt një përroi të vogël. Në këtë mbasditë me diell, kodra ishte mbushur me fëmijë që bënin ski dhe slita, të grumbulluar bash njësoj si arnjatë prej pellushi. Përgjatë rrugës nga shtëpia e tij ishte një fushë me gardhe të mëdha-një mjedis shoqëror, që kultivohet vetëm në verë; kur tashmë ishte thjesht një shtrirje e gjerë e bardhë, i cila dominohej nga një varrezë e vogël

në kodër, ngjashëm me një copë që tërhiqej nga kuajt dhe disa gra me shami ishin mbledhur para derës së një kishe druri të pikturuara me blu të ndritshme, kryqëzimet ishin të mbjella në goshkut e cepave dhe kishte trëndafila të ndritshëm dhe lule artificiale të kuqe, të cilat qëndronin gjysmë të varrosura në borë. Ishte, gjithsesi një varrezë e gëzuar.

Veranda e shtëpisë e bënte të dukesh shumë si hapësira e një shtëpie amerikane e dyzetë viteve të shkuara, por përpara të dukej pak edhe si ruse. Ato qëndronin ashtu bashkë afër me njëra-tjetrën dhe të jepnin ndjenjën e një pylli të thellë, megjithëse kishte vetëm pak korrije, që ishin ndër të përgjatë qytetit.

E pagova shoferin dhe me drithërimë të madhe shtya derën e hapur të kopshtit nga rruga dhe iu afrova ngadalë shtëpisë së errët. Në verandën e vogël, nga njëerë anë, kishte një derë me një shënim të zbërdhulur, gjysmë të çjerrë dhe shkruar në anglisht, e cila ishte ngjitur diku shkujdësshim dhe që shkruante: "Jam duke punuar. Nuk pres askënd. Ju lutem largohuni". Pas një momenti të tërë hezitimi, zgjidha të mos e respektoja, më shumë nga fakti që ajo dukej se ishte e vënë aty prej shumë kohësh të shkuara dhe për shkak të asaj pakos së vogël, që mbaja në duar. Trokita dhe pothuaj aq menjëherë u hap edhe dera-nga vetë Pastërnaku.

Ai mbante një kapele strakhani. Ishte tmerrësisht i bukur; me mollëzat e kërcyera dhe sytë e errëta bashkë me kapelën me qime, që e bënte të dukesh sikur kishte dalë nga ndonjë prej atyre përrallave ruse. Pas një ankthi të vazhdueshëm, e cila më kishte përcjellë udhëtimi, papritmas u ndjeva i qetësuar-më dukej se kurrë s'kisha dyshuar se do të takoja vetë Pastërnakun.

U paraqita vetë si Olga Andreev, e bija e Vadim Leonidovitch, duke përdorur mes-emrin e tim eti. Ishte i ndërtuar nga emri i tij i vërtetë dhe ai i babait, një shkrimtar i tregimesh dhe dramaturg, Leonid autor i dramës "Ai që u qëllua me dackë" dhe "Të shtatët që u varën". Andreev është në të vërtetë një emër shumë i zakonshëm në mes të rusëve.

U desh gati plot një minutë Pastërnakut, të kuptonte se vija nga jashtë shtetit. Ai më përshëndeti me shumë ngrohtësi, duke marrë dorën mes dy të tijave dhe më pyeti për shëndetin e nënës dhe shkrimet e babait si dhe për kuj-

A

ARGUMENT

Ushtaraku kanadez me origjinë shqiptare, pjesë e strukturave të NATO-s, e mbaron këtu konceptin e tij për një shtet demokratik, si Shqipëria, duke pasur parasysh kushtet e saj. Në formën e një traktati, autori mëtoi të përcjellë shumë mendim, por mbi të gjitha një koncept të drejtë dhe fair, të vendit të tij, që të jetë pjesë normale e komunitetit demokratik të botës...

Sipas tij, forcat politike ligjërojnë me konsensus funksionet shtetërore që emërohen prej qeverive të tyre por që dalin jashtë kontrollit të qeverisë fill pasi bëhet emërimi dhe nuk preken dot, veçse në rastet e parashikuara me ligj. Shembulli më tipik i kësaj kategorie janë gjykatësit por jo prokurorët. Për të përcaktuar një pozicion të tillë në një shtet ligjor dhe modern ka procedura dhe konsiderata të caktuara të cilat nuk janë objekt analize i këtij shkrimi...

Një vështrim sfidues për atë ç'ka duhet të vijë më pas

NGA KOSTANDIN RISTANI

Lexuesi që ka arritur në këtë pikë të shkrimit pret me të drejtë që në këtë pjesë të propozohet e parashtrihet zgjidhja ose variantet e zgjidhjeve për problemet e analizuara në funksionimin e shtetit shqiptar. Kjo për mua përbën sfidën më të mundimshme në këtë ndërmarrje intelektuale për disa arsye.

E para, kultura jonë shqiptare jo rrallë e stigmatizon bashkëbiseduesin kur ai fillon të propozojë zgjidhje për një problem në diskutim aq sa shprehja "po na shet mend" është pothuajse shprehja më e përdorur apo e menduar në të tilla rrethana.

E dyta, përsëri kultura jonë shqiptare e ka tmerrësisht të vështrur durimin për të dëgjuar bashkëfolësin deri në fund dhe pa e ndërprerë. Pra e theksoj se neve si grup shoqëror nuk jemi aspak të prirur për të dëgjuar por në të kundërt jemi të prirur për të llo-motitur të parët edhe për gjëra që as ja kemi idenë se si funksionojnë. Neve na pëlqen vetëm të dëgjohe-mi dhe jo të dëgjojmë duke harruar se komunikimi njerëzor është dy kahesh dhe jo një kah. Neve duam ta shkatërrojmë bashkëbiseduesin deri në "vdekje" me ndërhyrjet tona për të treguar që vetëm neve kemi të drejtë në argumentin në fjalë ose për të imponuar "dhunshëm" këndvështrimet tona.

E treta, kultura e shoqërisë në të cilën unë jetoj tani dhe me të cilën riedukova dhe po riedukoj vazhdimisht e unë ndërpreje mungesat që unë vija dhe vë re në formimin tim ashtu siç e perceptoj unë emancipimin dhe civilizimin, nuk e stimulon, mbështet e përkrah dhënien e pakërkuar të dijeve dhe eksperiencës dhe në një audiencë të pайдentifikuar. Pra, unë nuk jam i sigurt për llojin e audiencës që është e interesuar për të pranuar "shitje mendsh" e për të dëgjuar opsione sfiduese që shoqëria dhe shteti shqiptar mund të adaptojnë e ndjekin.

E katërta, problemet e zbuluara dhe analizuara në këtë shkrim kanë pasojat tejet serioze mbi gjeneratën të kombit dhe shoqërisë shqiptare në tërësi e në të gjithë spektrin politik të saj. Si rezultat i kësaj unë nuk jam i sigurt se forcat politike dhe grupimet e ndryshme në Shqipëri aktualisht janë të predispozuar dhe kanë vullnetin e mirë politik e moral që të bashkëpunojnë, bashkërendojnë e institucionalizojnë organizata apo organizime të zhvillimeve e drejtimeve strategjike kombëtare pa i monopolizuar, politizuar, futur nën tutelë e më vonë dhunuar vep-

rimtarinë e pavarur e objektivitetit të tyre. Ky organizim i institucionalizuar shtetëror duhet të ketë status të veçantë ku krahu dhe dora e partive e forcave politike s'arrin dot.

E pesta, fatkeqësisht modelet që drejtuesit e shtetit shqiptar historikisht kanë zgjedhur, kopjuar e imponuar për strukturën e shtetit dhe administratës shtetërore janë nga më të pakompletuarit, me shumë boshllëqe e mangësi, mjaft të thyeshme e arbitrare bile edhe që kanë falimentuar dhe që për të mos shkuar më tej vetëm gjatë shekullit të njëzet kanë lejuar e imponuar diktaturat e tmershme në shoqëritë e tyre dhe ndonjeha prej tyre ka shkaktuar katastrofa njerëzore evropiane e botërore. Edhe sot e kësaj dite drejtuesit e shtetit shqiptar i referohen shpesh e pa ndërprerje këtyre modeleve



bile njëri prej tyre është vërtet sim-boli dhe djepi i principeve të lirisë, barazisë e demokracisë të civilizimit modern perëndimor dhe që ka

arritur një aplikim shembullor në shoqërinë e vet, por e kaluara jo e largët koloniale e këtij modeli as edhe në një rast të vetëm nuk ka

arritur të ndërtojë një shtet tjetër me këto virtyte, përkundrazi ka lënë nga pas lufta civile, anarki e lëvizje terroriste.

Vetëm një model shteti që fatkeqësisht shihet si fuqia më e rreptë koloniale dhe imperiale e njerëzimit dhe që pavarësisht nga vuajtjet njerëzore që ka shkaktuar në shekuj mund të thuhet se ka servitur modelin më të suksesshëm si në vendin e vet ashtu edhe në mjaft vende të tjera të botës e me kultura të ndryshme dhe që nuk mjaftojnë gishtat e një dore për t'i numëruar. Drejtuesit e shtetit shqiptar historikisht e kanë injoruar e përbuzur deri në armiqësim kësaj model shteti dhe unë s'jam dot asnjë hamendje se pse ka ndodhur kjo.

E gjashta, kombi shqiptar ka një nga fatkeqësitë më të veçanta e më tmerrshme që ka pasur ndon-

Pse e shkrova këtë punim

NGA KOSTANDIN RISTANI

Duke punuar prej rreth 20 vjetësh në Shqipëri në funksione të ndryshme tekniko-drejtuuese dhe më pas, prej më se 25 vjetësh, në Kanada, fillimisht në sektorin privat dhe pastaj në sektorin publik federal, i mbështetur nga një arsimim dhe kualifikim universitar dhe pasuniversitar të kryer në të dy vendet e përmendura më sipër, kam grumbulluar një eksperiencë, ekspertizë dhe pjekuri mjaft të çmuar dhe të pakrahshme edhe për nivelin e standardeve Amerikano-Veriore, të cilën po e vë në shërbim të njerit prej dikasterve më të rëndësishme të administratës shtetërore të Kanadasë si punonjës civil publik në cilësinë e analizës, përpilimit dhe mbështetjes së drejtimit strategjik në fushën përkatëse.

Veçantia dhe përparësia e fituar në formimin tim individual të deritanishëm nuk është rezultat i ndonjë spekulimi mbi aftësi të jashtëzakonshme individuale por përkundrazi, rezultat i kushteve dhe rrethanave specifike të



jetës sime që përfshin: eksperiencën e dy sistemeve shoqërore diametralisht të kundërta; eksperiencën e dy shoqërive e marrëdhënive njerëzore brenda tyre që përfaqësojnë nivele shembullore tolerance/intolerance dhe emancipimi/primitivizimi në kategoritë përkatëse; eksperiencën e dy varianteve të plota arsimimi përkatës të përfunduara në nivelet më të larta e në pajtuesmëri me kërkesat rigorozë të secilit sistem; eksperiencën e dy punësimeve përkatëse në sektorin publik me konkurrim të pa kompromentuar e të pa kontestuar (pavarësisht nga korrektesa e rregullave të konkurimit); pavarësia e plotë dhe e pa angazhuar gjatë gjithë rrjedhës së jetës time të deritan-

ishme ndaj grupeve e forcave politike në të dy sistemet e vendet dhe që manifestohet në pavarësinë absolute të mendimit tim intelektual ndaj tyre; dhe së fundi në integritetin dinjitoz personal dhe profesional, analitik e racional të pa cënuar e njollësor. Në këtë analizë patjetër ndikojnë dhe nuk mund të përjashtohen besimi, botëkuptimi dhe filozofia e bindjeve të mia personale.

E shpjeguar më tej kjo përparësi, e që unë besoj se është e veçantë në mes antarëve të shoqërisë shqiptare të brezit tim, përbën mpleksjen më të përkryer të arritjeve të mia arsimore, tekniko-profesionale dhe drejtuese, si në shoqërinë shqiptare ashtu edhe në atë kanadeze, pa anësi, shtytje e përkrahje artificiale të njohjes, lidhjeve, kompromiseve apo hatërve sa mbizotëruese në shoqërinë shqiptare aq edhe të papranueshme në shoqërinë kanadeze. Kjo që pohova më sipër mund të shpjegohet më tej si ndërthurje e pavarësisht së plotë time ndaj çdo individ të veçantë dhe vartësisht së plotë time (në kohë të ndryshme) ndaj të dy sistemeve dhe shoqërive të përmendura më sipër.

Megjithë zhgënjimet dhe pakënaqësitë e pafundme e plotësisht

të justifikuar përpara ndërgjegjes time personale dhe etnike, që kam pasur kundrejt shtetit shqiptar në tërësi në të gjitha sistemet e jetuara në atë vend, prap se prap ndjenja e origjinës, përkatësisë, detyrës dhe e profesionalizimit intelektual më bën që të mendoj shpesh se pse unë, me këndvështrimin analitik timin, mos të kontriboj edhe ndaj shoqërisë shqiptare, që jeton dhe nuk gëzon në atë vend funksionet e një shteti modern siç e meriton një shoqëri që aspiron për t'u quajtur Evropiane dhe e emancipuar. Kësaj ndjenje i shtohet edhe shtytja e fortë që kam shpesh herë nga brenda vetes kur shoh se sa cmohen dhe vlerësohen analizat dhe rekomandimet e mia në ambientin e punës së tanishme dhe se përse strukturat shtetërore të vendit tim të origjinës të mos përfitojnë në të mirën e shoqërisë shqiptare nga kjo experiencë e fuqishme e grumbulluar vetëm me punë, djersë, sakrificat dhe përkushtim.

Sipas mendimit tim "periudha kalimtare" apo "përgatitore" e përmendur dhe artikulluar shpesh herë nga opinione të ndryshme shqiptare e këshilltarësh perëndimorë po zgjatet pak si tepër për

jë komb evropian: raporti ndërmjet mendjeve e figurave më të ndritura të tij, në të gjitha kohërat pa përjashtim, që kanë punuar jashtë vendit e për të tjerë ndaj atyre që kanë punuar brenda vendit e për Shqipërinë është një numur shumëfish dhe jo një fraksion. Vetëm ky fakt është dhimbshmërisht ç'inkurajues për të gjithë intelektualët e tjerë të racës shqiptare kudo që janë dhe jo të këti kalibri madhor.

Problemet e përshkruara dhe të analizuar në këtë shkrim dhe me të cilat ballafaqohet shoqëria dhe shteti shqiptar janë shumë serioze për vetë ekzistencën e saj. Sa më tepër që të shtyhen dhe të injorohen këto probleme aq më tepër kohë do t'i duhet shoqërisë shqiptare për të dalë nga kjo gjendje vetëshkatërruese dhe për t'u emancipuar, rimëkëmbur e zhvilluar. Por mos të harrohet se ky injorim e mosveprim mund të shtrihet shumë në kohë saqë shoqëria dhe shteti shqiptar praktikisht falimentojnë e dështojnë dhe bëhen të paafte për t'u rimëkëmbur vetë. Ky pohim nuk është një keqdashësi ose dëshirë ndjellakeqe por është një rrezik potencial që ekziston dhe duhet e mundet të shmanget. Një njeri i vetëm sado i veshur me pushtet nuk munda ta ndryshojë këtë rrjedhje dhe formula e receta të gatshme që mund të ndiqen me lehtësi s'ka. Zgjidhjet kërkohen në vullnetin kolektiv për të hartuar e marrë pjesë në zbatimin e një plani me drejtim strategjik të qartë dhe të detajuar me objektiva e afate.

Lexusi i vëmendshëm i pjesës së dytë të këtij shkrimi mund ta ketë nuhatur menjëherë se dy janë frontet kryesore ku zgjidhja shpallset me tërë hapsirën përfshirëse të saj:

1) Hartimi i varianteve e drejtimeve strategjike për një zhvillim ekonomik kombëtar që sigurojnë të ardhura të mjaftueshme, të kon-

trollueshme e të vazhdueshme për të mbuluar shpenzimet dhe shlyerjen e detyrimeve. Si rrjedhojë hartimi e detajimi i një plani ekonomik afatgjatë për vënie në jetë të variantit më të pranueshëm, më të realizueshëm dhe më të levertisshëm strategjik;

2) Hartimi i një plani ambicioz e agresiv për identifikimin e sferëve dhe programeve më të rëndësishme që ka shteti për të kryer normalisht funksionet e sipërpërmendura dhe planifikimi e zbatimi i të gjithë hapave të hollësishme për të vënë në jetë e punë këto sferëve e programe.

Si përfundim, përsa i përket frontit të parë veprues të paraqitur po më lart, unë mendoj se kombi e shoqëria shqiptare ka intelektualë shumë të aftë që mund të drejtojnë e kontribuojnë intensivisht në këtë drejtim. Ky front mendoj se mund të atakohet me një pjesëmarrje mjaft të gjerë të personalitetëve intelektuale shqiptare të të gjitha fushave të aktivitetit njerëzor por sidomos ekonomiko-financiar dhe ligjor. Ky front mendoj se duhet institucionalizuar sipas arsyetimit dhe logjikës së shprehur në paragrafin e arsyes së katërt të kësaj pjesë.

Ndërsa sfida ime personale qendron në përgjegjësinë time intelektuale, profesionale dhe qytetare për të pranuar rolin kryesor në drejtim dhe kontribut intensiv në frontin e dytë hartues e ndërveprues të paraqitur pak më lart. Kjo rrjedh nga vetëdija e njohjes mjaft të mirë të gjendjes se ku kemi qenë, ku jemi e ku duhet të jemi po ashtu dhe nga visioni tërësor i rrugës që duhet të përshkrojme për të arritur aty ku duhet të jemi.

Duke qenë i bindur se po ngacmoj e nxis një frymë të re përkushtimi atdhetar të emancipuar, mbetem i kushhtëzuar nga shkalla e pranimit e përkrahjes së kësaj bindje nga lexuesi shqiptar e shqipfolës kudo qoftë.

shoqërinë dhe shtetin shqiptar. Me mendësinë e tanishme, tejet primitive, me të cilën shoqëria shqiptare, nëpërmjet grupeve politike që e përfaqësojnë atë, ndërton shtetin dhe qeverisin e administrojnë vendin, ndihmon të gjatë që kjo "periudhë kalimtare/përgatitore" të vazhdojë me dekada të tëra pa u arritur një gjendje e re deri diku solide, e formuar dhe përgjithësisht e përcaktuar. Historikisht shprehja "periudhë kalimtare" u ka pëlqyer pothuajse të gjithë politikanëve që kanë qeverisur (lexo: mashtruar) Shqipërinë dhe shoqërinë shqiptare këto 75 vjetë e fundit. Por më ironikja është se edhe publiku shqiptar duket se i pëlqen të mashtrohet me pritjen (që ndjehet si rendje) plot ankh drejt iluzionit që s'ka asnjë fund të përcaktuar me objektiva ekonomike e sociale strategjike të arritshëm, të matshëm e të krahasueshëm në çdo fazë.

Qëllimi i këtij shkrimi analizë është për të treguar këndvështrimin personal dhe të mirëinformuar tamin si edhe për të ndihmuar e kontribuar në projektimin e perspektivave të shoqërisë shqiptare për një shtet modern e ligjor - kjo në rast se grupi apo grupet drejtuese të shtetit shqiptar dhe opinioni i emancipuar intelektual-shoqëror e politik shqiptar ka dashamirësinë dhe e sheh me mendje të hapur e pa megalomani e xheloz mesjetare dhe emirë bizantine këtë vështrim analitik. Kundrejt çdo keqinterpretimi të qëllimit tim

të shprehur më sipër dëshiroj të pohoj me krenari të palëkundur se unë e kam gjetur një mbijetesë dinjitoze e mjaft të lakmuar nga shumë individë të shoqërisë kanadeze pa nevojën dhe domosdoshmërinë e shtetit shqiptar, ndërsa shteti dhe shoqëria shqiptare e ka tejet dhe dhimbshmërisht të nevojshme modernizimin dhe emancipimin e tij dhe të saj me kontribute të grumbulluara nga përvoja të suksesshme e jo të dështuara, të provuara e jo të stisura, të pa stimuluar nga nepotizmat e patronazhet lidhës miqësoro-fisnorë, të pa injektuara nga interesa e faktorë rrethorë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë apo edhe të këshilltarëve të huaj. Kjo mbijetesë e pa kompromentuar në etapa krejt të pabarbarta jetësore në shoqëritë shqiptare e kanadeze përbën një ndërthurje ideale e shumë të rrallë për një kontribut të zëshëm.

Për këtë qëllim vendosa të parashtrij mendime e mia personale në mënyrë analitike, jo të fundme dhe të plota, por specifike dhe të përgjithëdhura të funksioneve të një shteti modern që përfaqëson vërtet një shoqëri të emancipuar, të krahasuar ato me funksionet e shtetit shqiptar ashtu siç e kam jetuar vetë gjatë viteve të jetesës në Shqipëri dhe ashtu siç po e vëzhgoj me cilësinë e analistit vëzhgues, pas ndryshimit të vendbanimit tim kryesor, por gjithmonë nga afër, gjatë çdo qëndrimi tim në Shqipëri disa here në vit.

REVIEW

NGA BEN ANDONI

Ka një zakon të hershëm në vendin tonë, të cilën mund ta hasësh si indikacion deri tek Hahn, ku në udhëtimet e tij, fshatarët për t'i treguar vjetërsi të vendit ku jetojnë, i tregojnë udhëtarit tv famshëm kisha dhe numër të madh objekteve kishtare. Ky zakon, rrudhur në kohë për shkak të revolucionit antifetar në vendin tonë, ishte e rrënjësor jo thjesht të pjesa e folkut por lexuesi e haste deri në sintezat e punimeve që studiuës të ndryshëm vendas për të treguar identitetin kombëtar nën Perandorinë Osmane e theksonin identitetin fetar; kuptohet duke ju ruajtur ngjyresave. Për hir të së vërtetës, Perandoria Osmane krahas asaj politike që ndoqi kundër shqiptarëve nuk është se u tregua kaq e ashpër me klerin. Ky i fundit, i rrudhur në kushte jo aq të mira, jetoi mirë nën shtëullën e perandorisë.

Inxhinierët dhe studiuesit Genc Samimi dhe Dritan Çoku, dy njerëz që merren kaheër me Beratin, alias "Qytetin e Bardhë" u munduan dhe sollën për publikun ditët e fundit një libër të jashtëzakonshëm studimor në gjininë e monografisë, me një material të detajuar për kishat e qytetit të Beratit. Genc Samimi, restauratori veteran e përshkruan me kujdes këtë situatë dhe amullinë që ekzistonte para disa dekadash në kohën kur bënte punën e tij restauruese dhe konservuese në kalanë dhe qytetin e Beratit. Dhe për ta zgjidhur këtë rebus, në bashkëpunim me një studiues të nderuar të Beratit, ata arritën të sjellin një monografi me pretendime shumë të larta, botuar nga PEGI, me ndihmën e shumë dashamirëve për kulturën. Rrethanat historike të Krishtëritimit dhe pastaj Kalatë janë dy seksione bosh të kësaj monografie, që ka elementë të ilustruar deri në detaje më të imta dhe plotësuar me një kronologji fotosh shumë interesante. Autorët e nisën punën si sfidë por duket se burimin e shkruar më të madh e të rëndësishëm për idenë lidhur me numrin real të kishave e mbështetën në librin historik me titull: "Përshkrim i shkurtër historik Metropolisia e shenjtë e Beligradit (Beratit)", i botuar nga

Inxhinierët dhe studiuesit Genc Samimi dhe Dritan Çoku, dy njerëz që merren kaheër me Beratin, alias "Qytetin e Bardhë" sollën për publikun ditët e fundit një libër të jashtëzakonshëm studimor në gjininë e monografisë, me një material të detajuar për kishat e qytetit të famshëm. Genc Samimi, restauratori veteran, e përshkruan me kujdes këtë situatë dhe amullinë që ekzistonte para disa dekadash në kohën kur bënte punën e tij restauruese dhe konservuese në kalanë dhe qytetin e Beratit...

Kishat e kalasë së Beratit për herë të parë në një monografi të plotë



in plot 40 kisha, një shifër që më shumë se hipotetike nuk i përgjigjet strukturës së hapësirës së kalasë. Megjithatë, paçka shifrës së fryrë të kishave duhet thënë se ato ekzistueset kanë qenë të një niveli të tillë, saqë jo vetëm e justifikojnë namnin, por i japin të gjithë religjionit shqiptar një vello nderimi të pashembullt.

Do të ndaleshim më shumë në pjesën kristiane, jo për ta veçuar, por ngaqë kjo shkollë më shumë me temën tonë. Sgarojmë se në Berat, këtij niveli, i është përgjigjur dhe një nivel sipëran dëshmish të tëra dorëshkrimore, që përfaqësojnë intelektualët e njerëzve që i bënë ato. Është e pakët të thuhet sot se Kodiku i Purpurt (Codex Purpureus Beratinus O) i shekullit VI, i shkruar në pergamen të purpurt, përbën një nga fare pak kopjet e vetme të gjetura të këtij lloji, në të gjithë botën. I dyti është Kodiku i Artë (Codex Aureus), i shekullit IX, shkruar në

pergamen me shkronja ari. Të

shkruara në greqisht, ato u ribulluan në kështjellën e qytetit dhe pas restaurimeve të kujdesshme jashtë vendit, sot, ruhen në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë". Genc Samimi, që ka vite që punon në këtë qytet, por edhe më një përvojë të vyer dhe studiuesi i nderuar Dritan Çoku bën një gjë shumë të bukur sepse shkuan thellë dhe u morën realisht me dokumentimin dhe gjithçka dihet deri më sot qoftë me zbukurimin e interioreve dhe elementët arkitektonikë të kishave, ku mund të shihet dora e artistëve vërtetë të zotë vendas dhe mbase dhe shumë të huajve syresh.

Dy autorët e mrekullueshëm Onufri dhe i biri Nikolla janë aty dhe fare të kapshëm me shtetimin që bën shumë përcjellje në forma të ndryshme përmes skicimit, fotografisë, detajit, shpjegimit të ngushtë dhe historisë të çdo objekti, ku një lexues shikon shtrirjen e gjatë të kulteve dhe në periudhën paleokristiane, ku falë detaje arkitektonike si disa kolonada dhe kapitelle interesante, bëhet e dukshme ekzistenca e kishave paleokristiane prej shekujve IV-VI (Shën Todri). Kishat e shekujve XIII-XIV si Shën Mëhillahna, Shën Triadha dhe Shën Mëhilli janë të paarrtueshme, sa i përket elementeve dhe komplet strukturës. Dëshmi e bukur e një pune të bukur por më shumë se caq përmbledhja e një historie e cila s'mbaron prej shekujsh.

A

ARGUMENT

Në kapërcyell të shekujve XX dhe XXI, në vendin tonë peizazhi (sidomos ai natyror) u lëvrua nga mjaft fotografë, ndër më të suksesshmit përmendim Leon Çikën, Zamir Marikën, Nikolin Babën, ndërsa nga Kosova shënojmë Afrim Spahiu, Naim Shala, Fahredin Spahija. Në rreshtin e parë të peizazhistëve të Republikës së Shqipërisë, ka vendin e tij të merituar edhe pogradecari Ardian Fezollari...



NGA QERIM VRIONI

Në historinë e fotografisë botërore, peizazhet, bashkë me portretet përbëjnë dy gjinitë më të hershme të lëvruara qysh nga mjeshtrat e parë të kësaj veprimtarie. Kështu, ndër më të vjetrat shënojmë peizazhin (urban) të francezët Louis-Jacques Daguerre me titull "Pamje e Bulevardit të Temple" (1838) dhe atë natyror të anglezit William Fox-Talbot me titull "Disa pemë" (1842). Jo rastësisht, këta janë edhe dy shpikësit më me peshë të fotografisë. Në peizazhet natyrore, përgjithësisht nuk duket njeriu dhe *dora* e tij, ndërsa në ato urbane shihen edhe ndjërtesa, ura, rrugë, me fjalë të tjera gjithçka e krijuar nga njeriu.

Më pas, me përparimin e proceseve teknologjike, peizazhi fotografik nisi të dukesh përherë e më shumë në *portfolio*-t e mjeshtrave të "dhomës së errët", natyrisht gjithmonë në foto bardhë e zi. Nga fundi i shekullit XIX, fotografët me ambicje artistike synuan të krijojnë peizazhe të përafërta me ato të piktorëve duke formësuar rrymën e quajtur *pikturalizëm*, që vazhdoi deri nga fillimi i shekullit XX, kohë kur i shteruan fuqitë. Po nga vitet '20 të qindvjetshit të kaluar, fotografi amerikan Ansel Adams u dallua për peizazhet natyrore të botës së vendlindjes së tij, duke i dhënë peshë të re peizazhit.

Prej atëherë, peizazhi është lëvruar gjerësisht nga fotografët, thuhet nga të gjitha vendet e botës, me to hapen ekspozita, konkurse, ka revista periodike dhe botohen albume, me ngjyra, por edhe bardhë e zi.

Në Shqipëri, mesa dihet deri tani, historikisht, ndër peizazhet e parë mbahen, shkrepje të Kristo Shulit, Thimi Racit, Kel Marubit, Kristaq Sotirit, Misto Cici, Ymer Balit, e sidomos të Shan Picit, i cili dallohet për numrin e madh të pamjeve të natyrës (sidomos Alpeve të Veriut) të përngjirë në letërnatë fotografike dhe për nivelin e tyre. Gjithsesi, mendohet se një pjesë e mjeshtrave i realizojnë peizazhet për kartolina postare... Gjatë gjysmës së dytë të viteve 1900, në vend u zhvillua veçanërisht peizazhi urban ose i etiketuar nga socrealizmi, *peizazh industrial*, në të cilat si propagandë e pastër, pasqyroheshin ndërtimet e veprave të til-

ARDIAN FEZOLLARI, liriku i peizazhit fotografik

la si fabrika, hidrocentrale, ura, rrugë, tunele, për të shfaqur kësajsojë madhështinë e sistemit diktatorial komunist. Këto peizazhe mbushnin faqet e shtypit të partisë-shtet nga fotoreporterët e ATSH dhe gazetave dhe revistave të kohës, ndër to edhe me vlera estetike, ndonëse parësore në to ishte agitacioni figurativ. Jo shpesh, gjatë asaj ndërkohe botohej edhe ndonjë peizazh natyror, me ngjyra ose bardhë e zi.

Në kapërcyell të shekujve XX dhe XXI, në vendin tonë peizazhi (sidomos ai natyror) u lëvrua nga mjaft fotografë, ndër më të suksesshmit përmendim Leon Çikën, Zamir Marikën, Nikolin Babën, ndërsa nga Kosova shënojmë Afrim Spahiu, Naim Shala, Fahredin Spahija. Në rreshtin e parë të peizazhistëve të Republikës së Shqipërisë, ka vendin e tij të merituar edhe pogradecari Ardian Fezollari.

Më 1994, pasi kishte kryer Shkollën e lartë të Policisë për ekspert kriminalist, ai nisi të merrej seriozisht me fotografimin për pasion ose si *hobby*. Në të vërtetë, edhe profesioni i tij si kriminalist e kishin përdorimin e aparatit fotografik si një nga disiplinat e detyrueshme të punës. Sidoqoftë, më vendimtar në ushtrimin e pasionit për "dhomën e errët", mendojmë se ishte peizazhi i rrallë piktorik i Pogradecit, qytetit të liqenit më të bukur të Ballkanit. Kështu, ai ushtron profesionin e oficerit, por pa hequr asnjë cast aparatit nga krahu për të kapur peizazhe.

Në vitin 1996, Ardian Fezollari hapë ekspozitën e parë fotografike vetjake, e cila u pëlqye nga publiku artdashës i Pogradecit. Tani përkushtimi për fotografimin e kthye në një pasion të fortë për *oficerin e policisë kriminale*, dhe vlerësimet për të nuk vonuan. Në vitin 2000, ai u nderua me Çmimin e Tretë në Ekspozitën e Agjencisë

Kombëtare të Turizmit, çka shtoi kërkesat e tij për foto sa më të arrira estetikisht. Ndërkohë, ai merr pjesë në ekspozita të ndryshme fotografike jashtë vendit, si në Maqedoni, Bullgari, Austri, Egjipt, Danimarkë etj., herë duke përfaqësuar veten dhe, herë vendin. Në vitin 2006, Ardian Fezollari doli para publikut me botimin serioz me titull "Landscape" (Peizazhe), një album me format të madh dhe letër cilësore, por mbi të gjitha cilësore ishin fotot që përmbante vet albumi.

Peizazhe fotografike nga Pogradeci janë realizuar edhe nga vitet '20 të shekullit të kaluar nga mjeshtri i aparatit, Misto Cici (1902-1981), një pjesë e të cilave u shtypën si kartolina (bardhë e zi) në Itali për tregun e brandshëm dhe të jashtëm. Pra, fotografimi i natyrës së qytetit dhe liqenit, për ta përfunduar në letër, nuk ishte diçka që bëhej për herë të parë vitet e fundit. Ndoshta Fezollari ka përfutur edhe nga përvoja e peizazheve të Cicit, por dhe e ka çuar në një stad më të lartë nivelin e tyre, natyrisht jo prej përparësive teknologjike të kohëve të sotme.

Për disa vite rresht Ardian Fezollari me nismën e vet, ka organizuar në Pogradec "Ditë e Fotografisë", me *artistë të aparatit* nga i gjithë vendi, madje edhe nga Kosova e Maqedonia, një nga veprimtaritë e rralla që i bashkon ata. Në to, mjeshtrat e futuar të aparatit, kanë ekspozuar foto të tyre dhe kanë shkëmbyer përvoja vetjake.

Po çfarë e ka shtyrë Ardian Fezollari t'i përkushtohet me aq pasion (do thoshim edhe me sukses) edhe fotografisë (veçanërisht peizazhit), përveç punës si ekspert kriminalist? Një përgjigje e shpejtuar do ishte, njohja me fotografimin dhe aparatit si pjesë e detyrës si oficer i diplomuar. Po të ishte kjo përgjigja shteruese, atëherë në çdo komisariat do kishte fotografë peizazhista të njohur në botën shqiptare të fotografisë, çka nuk është e vërtetë. Peshë kryesore, mendoj se e ka pasur edhe natyra e veçantë e Pogradecit me liqenin e tij të *bekuar*. Nuk duhet lënë pa përmendur kurajimi i Ardian Fezollari për të hyrë thellë dhe vazhduar pandërprerje në lëmin e fotografisë, nga mësuesi i tij i vizatimit, piktori i ndjerë pogradecar Skënder Lako.

Peizazhet e Fezollari janë përgjithësisht, me ngjyra, ashtu siç është natyra, të cilën ai si *dashnor* i flaktë e fotografon, duke ndërjer tek mollëza e gishtit tregues *Jlirim* sa herë shtyp butonin. Stinë më të pëlqyera në Pogradec për të janë vjeshta dhe dimri. Kjo nuk do të thotë se aparatit i tij *ze ndryshk* në pranverë dhe verë. Jo, ai thuhetse çdo ditë fotografon, duke nisur qysh në mëngjes, gjatë rrugës 50 kilometër-she për të mbërritur në vendin e punës, të cilën e përshkon me ndërprerje të *detyruara* nga pamjet piktorike që kap syri i tij i stërvitur për të dalluar të bukurën nga e zakonshmeja. Natyrisht, edhe gjatë kthimit nga puna, sidomos në mbrastite dhe mbrëmje me ndriçim të mënjanshëm, të butë dhe të pjerrët, ai s'ërisht e ndalon makinën, dhe...nis të fotografojë.

Po ku qëndron vlera tipike e peizazheve të Ardianit? Së pari në gjetjen e *të veçantës* dhe futjen e saj në katërkëndshin e kuadrimit, atë që një sy i zakonshëm nuk e dallon. Kësaj si shtohet edhe përfytyrimi i tyre paraprak që e *shikon* peizazhin të ndehur në letërnatë fotografike, shumë përpara se ta kryej laboratorit këtë proces. Po ashtu, si artist, ai synon dhe arrinë të kapi në çaste shumë të shkurtra kohe *një motiv* brenda fotos, që t'i përcjell diçka shikuesit kur ta ketë para syve, jo vetëm kumte estetike, ndonëse këto janë parësore në krijimtarinë e Fezollari. Kjo tendencë

e zgjedhjes së motivit i largojnë peizazhet e tij nga imazhet kartoline-leske aq të përhapura kur bëhet fjalë për fotografimin e vendeve me natyrë të dallueshme piktorike. Vërtetë themi se Pogradeci e nxiti Ardian Fezollari ta fotografonte, por mos vetëm qytetin e tij, liqenin dhe rrethinat di të fotografojë ai? Përvoja e tij disavjeçare e hedh poshtë këtë mendim. Ai ka fotografuar edhe jashtë vendit (Pogradecit po e po) peizazhe natyrore dhe urbane si psh, në Firence (Itali) dhe me të cilat ka hapur edhe një ekspozitë të posaçme, e pritit me kureshtje dhe kënaqësi nga italianët.

Përgjithësisht, me fotot më të zgjedhura e krijimtarinë së tij, ai merr pjesë në çdo veprimtarie që organizohet për fotografimin, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë e Maqedoni. Duke vështruar me vëmendje të shtuar peizazhet fotografike të Fezollari, mund të thuhet se ato ngërthejnë brenda tyre "filigrana të padukshme poetike", shenjë e sigurtë e shpirtit prej poeti të fotografit pogradecar. Ai, siç u përmend edhe më sipër, vazhdon me përkushtim të realizojë foto të arrira estetikisht dhe të pritura me kënaqësi nga publiku.

Ekspozita e fundit fotografike e Fezollari jashtë vendit, është hapur para 3-4 muajsh (18 dhjetor 2018) në Bukuresht (Rumani) me titull "Shqipëria, poetika e hapësirës" e cila u përurua me ceremoni, u vizitua po ashtu nga shumë dashamirë të fotografisë dhe u pasqyrua nga media vendase. Vet titulli mjaft i goditur i ekspozitës përbën edhe thelbin e punimeve të tij fotografike, ose më ndryshe *leitmotiv* e peizazheve të Ardian Fezollari, të ngjizura me aq dashuri në letërnatë fotografike. Kështu, ai mbetet një nga *virtuozët* më të shquar shqiptar të aparatit fotografik për kapjen e peizazhit.

Opinioni i Ditës

Tango dyshe kërkon më shumë

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... më shumë në garën vendore të 25 qershorit 2019, atëherë do të kemi menjëherë në shtator zgjedhje të parakohshme përbën lëshimin e parë të pozitës. Pyetja një milion dollarësh këtu është: a do të ketë kjo parti që organizoi dhe një kongres "nga fitorja në fitore" lëshime të tjera? A është e gatshme t'i bëjë, për hir të kthimit të qetësisë dhe normalitetit të jetës në këtë vend? Pikërisht tani, e përkëdhelur në sedër nga mbështetja e pakushtëzuar e të gjithë faktorit ndërkombehtar? E sigurt se e ka të tereztur garën zgjedhore, aq sa ta fillojë praktikisht fushatën një muaj e tre javë përpara 40 ditëshit zyrtar? Apo do të qëndrojë "shkëmb graniti" në guaskën e saj krenare të "bashkëqeverisjes me qytetarët", që është dhe do të ngelet një utopizëm dhe populizëm i pastër? Një kongres zgjedhor i organizuar gjysmë në rrugë, me fjalime patetike dhe pa asnjë analizë konkrete dhe kritikë e debat se çfarë u bë keq apo nuk shkoi në qeverisjen vendore të socialisteve në vitet 2015-2018. Një aradhe suksesesh dhe listash dëshirash për të bërë mirë për katër vitet e ardhshme(edhe pse mbështetur në një histori reale suksesi ai ajo e kryetarit të sotëm të bashkisë së kryeqytetit), ndërkohë që në katër vitet që lamë pas i janë larguar Shqipërisë 360 mijë vetë! Ose 60 mijë persona më shumë se sa premtimi i bujshëm për 300 mijë vende të reja pune i kësaj partie (edhe i një tjetre përpara kësaj), asnjëherë i mbajtur. Ajo që pamë dje ishte gjithçka, vetëm një tribunë e mendimit të lirë partiak, ku të mbizotërojë shqetësimi për situatën e sotme politike të vendit nuk ishte. Nuk ishte një analizë e thellë e kostos së jashtëzakonshme që po mbajnë shpatullat e brishta të imazhit të Shqipërisë si vend i qen-



drueshëm dhe normal, apo supet e një ekonomie tejte premtuese, por plotësisht peng e papërgjegjshmërisë ekstreme të politikës, si kjo e jona. Nuk pamë një ndjenjë përgjegjshmërie dhe fajti apo pranimit gabimi, lidhur me "qmendjen" aktuale të opozitës reale të vendit, që braktisi pa kthim parlamentin. Duke e bërë këtë parlament absurd dhe tërësisht grotesk për herë të parë në historinë e pluralizmit shqiptar. Një kongres zakonisht shërben si një moment reflektimi

për çfarë është arritur dhe çfarë jo në premtimet e dhëna votuesve dhe gjithë vendit për periudhën që kaloi. Këtë reflektim, këtë analizë të thellë dhe nxjerrje përgjegjësish konkrete për gabimet(pse jo edhe fajet) e qeveritarëve që sot kjo parti nuk i ka më mes veedit, nuk e pamë dje në kongresin zgjedhor të partisë Socialiste. Ajo është partia më e madhe e vendit. Ajo mban dhe përgjegjësitë më të mëdha për gjendjen e sotme politike të Shqipërisë sonë. Ajo priti një Godo që

mesa duket nuk do t'i vijë për një kohë të gjatë, themeluesin dhe frymëzuesin e shpirtit liberal brenda saj. Ia bëri ftesën të vinte, e priti me padurim të vinte dhe ishte krejtësisht e pasigurtë nëse Godoja(Fatos Nano) do të shfaqej në çastet e fundit. Nuk e pati këtë dhuratë. Në vend të saj, na dhuroi ne qytetarëve një spektakël entuziazmi fals dhe hipokrit, pasi gjendja reale është shumë e rëndë. Partia më e madhe e vendit nuk mund të bëjë strucin. Nuk mund të fshihet pas sukseseve imagjinare ose reale të korrura deri tani në pushtet. Kjo parti duhet të kishte kërkuar me forcë nga kryetari i sotëm i shtetit, të cilin e ka zgjedhur vetë, që të thërrasë tryezën e partisë kryesore politike të vendit. Dhe në këtë tryezë të paraqiten opsionet, variantet për zgjidhjen e krizës. Sado false apo fantapolitike të mund të tingëllojë sot kjo kërkesë, do të shërbente për uljen e gjakrave dhe kthimin real të ndërluftuesve në rrugë e dialogut. Partia më e madhe e vendit nuk duhet të dehet me miratimin e ndërkombehtarëve për qëndrimet e saj ndaj reformës në drejtësi. Kjo parti për këtë reformë ka bërë vetëm detyrën. Tani ka një detyrë shumë më të madhe përpara vetes. Të rikthejë mrekullinë e 17-18 prillit të dy viteve më parë. Të ripropozojë një marrëveshje ndoshta aspak të ngjashme, por me po aq peshe sa marrëveshja e në të gdhirë të datës 18 prill 2017, që shpëtoi vendin nga përshkallëzimi i një krize të jashtëzakonshme politike me opozitën-çadër jashtë zgjedhjeve të përgjithshme. Tango e demokracisë dhe e garës së drejtë zgjedhore luhet dyshe dhe Partia Socialiste ende nuk e ka siguruar partnerin e saj në garë, me gjithë garancitë e ndërkombehtarëve, që do të gabojë rëndë, po t'i konsiderojë si qetësuesit e duhur për këtë dhimbje të madhe koke në nivel kombëtar.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALLONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

HOROSKOPI

DASHI

Gjatë kësaj të diele do të jeni nën një atmosferë miqësore, të ngrohtë dhe dashurie. Mund të jeni pjesë e një eventi festiv ose e një dreke familjare. Sot do të dëgjoni fjalët që keni pritur prej kohësh nga partneri, partnerja juaj.

DEMI

Disa Demë do të ndihen shumë të irrituar. Gjendja financiare nuk do të jetë ashtu sikurse ju dëshironi duke ju shkakuar stres. Mos u përpiqni të luftoni me rrethanat. Rekomandohet të mos mendoni rreth problemeve, por të relaksoheni gjatë kësaj të diele.

BINJAKET

Binjakët nuk do të jenë të lumtur sot. Një gjendje e tillë mund të vijë për shkak të një konflikti me të afërmit tuaj. Mos u tregoni të ashpër kur debatooni, vetëm për të mbrojtur idenë tuaj. Ka gjasa që disa Binjakët mund të përfshihen në disa punë emergjente.

GAFORJA

Nuk do të jeni të saktë teksa kryeni disa përllogaritje matematikore. Si rezultat i kësaj, mund të gaboni gjatë një plani financiar. Shmangni çdo plan për të ardhmen gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, në mbrëmje do të kaloni momentet këndshme në shoqërinë e miqve të ngushtë.

LUANI

Për Luanët nuk parashikohen as probleme të vogla dhe as të mëdha. Megjithatë, kjo ditë parashikohet të jetë e mërzitshme. Ndoshta mund të qëndroni në shtëpi duke diskutuar për të ardhmen.

VIRGJERESHA

Nuk rekomandohet të ndjeni keqardhje për të kaluarën apo të kritikoni veten. Të gjithë këto mund të ndikojnë negativisht në fizik ashtu edhe në gjendjen tuaj psikologjike. Do të ishte shumë më mirë nëse dilni ose të shkoni në një udhëtim të shkurtër.

PESHORJA

Peshoret do t'ia kushtojnë këtë ditë vetes. Duhet të shmangni në mënyrë strikte alkolin dhe dietën e pabalancuar ushqimore, pasi mund të ndikojnë negativisht në shëndetin tuaj. Ata që janë në kërkim të dashurisë duhet të bëjnë përpjekje të pazakonta për ta fituar atë.

AKREPI

Sjellja e Akrepëve sot mund të jetë e paparashikueshme. Ka gjasa që thashethemet të përhapen shumë shpejt. Ata që nuk janë në gjendje të përballojnë një situatë të tillë duhet të tregohen të kujdeshëm.

SHIGJETARI

Çdo synim i juaj mund të realizohet nëse vëproni me vendosmëri dhe duke mos qenë nën presion. Kërkoni mbështetje nga të afërmit tuaj. Në fund të ditës do t'i harroni problemet dhe do t'i përkushtoheni partnerit/partneres suaj.

BRICJAPI

Për Bricjapët kjo e diel premtton të kalojë me trazira. Është koha e duhur të kujdeseni për veten, të ndryshoni stilin e flokëve, të blini veshje të reja ose të flisni hapur me partnerin/partneren.

UJORI

Ujorët do të dëgjojnë shumë këshilla të vlefshme sot. Nëse ndërprisni dikë teksa po përpiqet t'ju mësojë, do të ofendojë shumë. Arroganca nuk do të pritë mirë në shtëpinë tuaj. Kërkoni mënyrat për të rënë në kompromis me të afërmit tuaj.

PESHQIT

Peshqit mund të zhgëjohen sot. Arsyja për këtë mund të jenë veprimet e një shoku/shoqes suaj ose përfshirja në një trekëndësh dashurie. Mund të jeni edhe dyshues ndaj bashkëshortit/bashkëshortes suaj. Mos u përpiqni të merreni me probleme që nuk i keni të qarta.

Opinion i Ditës

Zonja e Ndjerë e Shkodrës dhe e kulturës shqiptare

Nga Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... politike në PS-në nga fundi i viteve 90.

Por rastin që ta njihja më nga afër e pata në gusht 2001, kur ajo erdhi dhe përshëndeti ceremoninë solemne të celjes së Ekspozitës Et-nografike të vendit tonë të organizuar nga ambasada jonë në Berlin në bashkëpunim me Muzeun Qendror të Mynihut.

Sidomos në atë kohë, kureshtja dhe emocioni kur takoje një ministere grua të këtij formati dhe e para nga Shkodra pas viteve 90 ishin të mëdha.

Ministria e Kulturës, Rinisë Sporteve, e ndjera Esmeralda Uruçi la mbresa te të pranishmit e shumë, te ne diplomatët dhe bashkëshortet tona me thjeshtësinë, çiltërsinë, përlulesinë dhe komunikimin e këndshëm e të natyrshëm. Ishim dhe në disa veprimtari të tjera gjatë dy ditëve që qëndroi në Mynih. Binte menjëherë në sy se te ajo mungonte sjellja dhe të folurit "ex katedra". Na kërkoi me sinqeritet mendimet tona për fjalën që do të mbante, tregonte respekt për përvojën tonë në diplomaci, krijonte intimitet dhe bënte heraherës dhe humor.

Këto cilësi të spikatura intelektuale të trashëguara nga familja ajo i kishte zhvilluar më tej qysh në bankat e shkollës dhe në të dy fakultetet ku ishte diplomuar (ekonomi politike/drejtesi) me rezultate të shkëlqyera.

Esmeraldës i ngarkuan detyrën e ministres në një gjendje tejte të rëndë që kalonte vendi ynë pas ngjarjeve të vitit 1997 - 1998 dhe konfliktit të armatosur në Kosovë. Vërtet qëndroi në atë post vetëm dy vjet, se aq e lanë, por s'fidat, jehona dhe arritjet ishin dhjetë herë më të mëdha se mandati i saj. Ish-te koha kur në Tiranë kërkohet dhe filloi me vrull ringritja e institucioneve kulturore të shkatërruara ndërsa në anën tjetër të kufirit lipsej po aq me urgjencë bashkëpunimi dhe ndihma për Kosovën dhe tratat e tjera që i mbanin sytë nga Atdheu i tyre amë. Veç të tjerash, kishte "uri" fondesh për të mbështetur gjithë këto veprimtari brenda vendit, por dhe në Kosovë dhe gjetkë.

Me po aq ngut kërkohet krijimi i një imazhi dhe perceptimi cilësor të ri për vendin, ku roli i kulturës, rinisë dhe sporteve ishte i pazëvendësueshëm. Aq më tepër që sapo ishte shpallur procesi i stabilizimit - asociimit me BE-në, ku arti dhe kultura jonë ofrojnë më shumë vlera se në çdo sektor tjetër.

Këtë mision dhe përgjegjësi historike ministria energjike e përballoi me sukses nga viti 1999 deri më 2001. Esmeralda nuk ishte spe-



cialiste kulture, por shumë më tepër se aq; ajo ishte misionare dhe personalitete rrezatuese që mishëronte frymën dhe vlerat më të mira të kulturës dhe rinisë tradicionale shkodrane dhe shqiptare.

Pikërisht në atë periudhë u organizuan veç të tjerash për herë të parë në 10 vitet e demokracisë pluraliste aktivitete dhe festivale të përbashkëta me institucionet kulturore, rinore dhe sportive të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi dhe u sigurua mbështetja financiare për krijimin dhe dërgimin e ansambleve tona artistike dinjitoze në Evropë, SHBA dhe gjetkë, krahas aktiviteteve tingëluese në Tiranë si "E duam Shqipërimë". Gjithashtu, u nderuan personalitete të spikatura të kulturës sonë jashtë vendit me titullin "Ambasadore të Kulturës Shqiptare" etj. Po gjatë asaj periudhe u propozua me dosjen përkatëse vullmunoze që Berati dhe Gjirokastra të pranohen në trashëgiminë botërore të UNESCO.

Tipar tjetër mbresëlënës, siç ka pohuar letrari dhe publicisti i njohur, Ermir Nika, ishte se si ministere, ajo nuk pranonte kurrësi të bënte emërime politike, nepotike, me lista dhe trysni nga Partia, por vetëm mbi bazën e meritave dhe të

CV-së reale. Mbeti deri në fund e papajtueshme me çdo shfaqje korruptsioni, abuzimi dhe dukuri të tjera negative që i ushqente trullit dhe mjedisi kaotik i asaj periudhe. Ajo karakterizohej, gjithashtu, nga fryma e respektit dhe vlerësimi i drejtë për bashkëpunëtorët dhe punonjësit e dikasterit dhe kulturës në përgjithësi.

Pasi militoi për vite me guxim, ndershmëri dhe qytetari në qytetin e saj të lindjes nën siglën e PS-së dhe LSI-së në Shkodër, ajo u largua nga politika aktive, ashtu siç hyri, pa zhurmë, pa sherre, pa inate personale. Sepse ajo nuk e shihte politikën si privilegj, por përgjegjësi, jo konflikt personash por kohezion në diversitet, jo si servilizëm por si shërbim ndaj publikut, jo si pazar individual por si perspektivë sociale. Por dhe xhelozitë e rasti përballë një politikaneje eksperte ndryshe dhe nga Shkodra e panjohur për të majtën deri atëherë, sidomos në gjendjen e ndërë në të cilën ndodhej PS-ja në vitet 2001 - 2003 nuk munguan. Por Esmeralda ishte dhe mbeti "esmeraldë" në personalitetin e saj vezullues, u fut me po atë pasion dhe zell aty ku ndihej më

e fortë në 'olimpin' e vet universitar akademik me një karrierë që e pasuroi më tej 10 vitet e fundit të jetës së saj dinjitoze. Lektore, dekanë dhe zvrrektore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës, promovuesja e njohjes së programeve "Bachelor" dhe doktoraturave në ekonomi, autore e shumë teksteve universitare, referuese në veprimtari ndërkombëtare shkencore në bashkëpunim me autorë të huaj, etj. Si Prof.Dr. në ekonomi, ajo ka shtjelluar me kompetencë të lartë efektet dhe pasojat e tranzicionit në fushën e turizmit, pronës, investimeve të huaja, biznesit të vogël e të mesëm, etj. Si pedagoge ajo shquhej dhe për lidhjen/ndërveprimin e natyrshëm me studentët dhe bashkëbiseduesit.

Me gjithë këtë veprimtari intensive të parreshtur, familjarët, të afërmit, shokët dhe shoqet e saj tregojnë me emociion dhe dhimbje se krahas kualiteteve elitare dhe akademike, Esmeralda ishte nënë, bashkëshorte, vajzë, motër, kolege dhe shoqe model; jo vetëm nuk mungonte, por ishte organizatore e rregullt e gëzimeve familjare te kolegët dhe bashkëpunëtorët me familjen e saj vërtet të shëndosë dhe solide; rrezatonte kudo dhe kudoherë seriozitet, mirësi, butësi, dhe thjeshtësinë tipike të qytetare shkodrane në çdo situatë.

Këtë e pohan dhe shoqja e saj e ngushtë e gjimnazit dhe Fakultetit Ekonomik, njëkohësisht kolege pedagoge, Dr. Majlinda Hafizi (Bushati) drejtore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave; ajo tregon me shumë dhimbje dhe krenari se nisur nga këto veti dhe virtyte fisnike, Esmeraldën e cilësonin "Zonja e Shkodrës" dhe e tillë ka mbetur përjetësisht.

Fatkeqësisht, këto kulme të aktivitetit të saj të gjithanshëm e të paretshur i ndërpreu papritur dhe tragjikisht në Vorë, në dhjetor 2011 goditja fatale pas automjetit me të cillin kthehej nga puna me Dashamirin, shokun dhe bashkëshortin e saj të pandarë. Me gjithë përpjekjet e mjekëve austriakë dhe luftën e përpur të së ndërës, ajo ndërroi jetë ditën e parë të pranverës, më 21 mars 2012, kur ishte vetëm 51 vjeç.

Ceremonia e lamtumirës në Teatrin e Operës dhe Baletit me homazhet e nivelit më të lartë nga të dy krahët e politikës dhe kultura jonë ishte e merituar dhe më e pakta që mund të bënte shteti dhe qeveria për këtë margaritar të arsimit dhe kulturës sonë.

Esmeralda la pas një trashëgimi të gjallë të misionit të saj të cilin e vazhdojnë miqtë, shokët dhe kolegët universitarë në Durrës, Shkodër dhe gjetkë. Po ashtu, të afërmit dhe familja Uruçi e mbajnë lart emrin dhe kujtimin e saj të çmuar Bashkëshorti, intelektual

i shquar Dashamir Uruçi, djali i Muhametit, luftëtarit dhe antifashistit të shquar, drejtuesit të arsimit të Shkodrës në vitet 40 dhe 50 vazhdon në gjurmët e të shoqes sidomos me riorganizimin e shoqërisë civile dhe me botime prestigjioze.

Veç të tjerash, Dashamiri bën pjesë prej dekadash te ata intelektualë me kontribut të jashtëzakonshëm qysh në orët e para dhe më të vështira kur dha gjithçka për çlirimin, mbështetjen, pavarësimin dhe demokratizimin e Kosovës; është bashkëthemelues dhe drejtuesi kryesor i Shoqatës atdhetare "Kosova" nga viti 1992 deri në shkrirjen e saj më 2008 me shpalljen e Pavarësisë.

Bujaria dhe solidariteti i çiftit Uruçi dhe dy fëmijëve të tyre shkëlqyen sërish gjatë konfliktit të dhunshëm në Kosovë, kur mbajtën celur për një vit të tërë dyert e shtëpisë në Shkodër për 15 familje me fëmijët e tyre të ardhur nga Dëçani.


Në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, vazhdon të punojë në gjurmët e nënës dhe profesores së tij të pahuarur djali, Enisi, si pedagog mjekësie; ashtu si prindërit dhe ai është diplomuar në dy universitete dhe po tani mbron doktoraturën. Falë dhe kualifikimit universitar për menaxhim biznesi, Enisi vazhdon të jetë aktiv dhe me rreth 15 publikime dhe referate shkencore mbi temat dhe reformat më të rëndësishme shëndetësore në revista dhe konferenca prestigjioze ndërkombëtare.

Vajza, Besmira, pas diplomimit me rezultate të shkëlqyera në Sorbonë për drejtësi, ka vite që punon dhe dy vitet e fundit drejton një departament të rëndësishëm juridik në Kompaninë e njohur "Selectra" në Luksemburg.

Ajo e shoqëronte shpesh qysh studente dhe si bashkëautore nënën e saj në konferenca jashtë vendit; në vitin 2013 Besmira përfaqësoi rininë shqiptare në UNESCO dhe në forumet të tjera si Sekretare e Përgjithshme e Universitetit Veror franko - gjerman, etj.

Këto vitet e fundit, gjatë punës në ambasadën tonë në Bruksel dhe në Luksemburg kemi ndjerë nga afër Atdhedashurinë, ndihmën, pasionin dhe pozitivitetin e saj tipik urriçjan; Besmira është ndër përfaqësueset më dinjitoze të komunitetit shqiptar në Luksemburg; prej gati dy vitesh, ajo është bashkëthemeluese dhe zvrkryetare e Dhomës së Përbashkët të Tregtisë Luxemburg - Shqipëri. Miqtë, kolegët dhe të afërmit e familjes ndjekin me vëmendje dhe adhurojnë Enisin dhe Besmirën kur pohojnë me butësinë dhe modestinë tipike se nëna e tyre e ndjerë ishte dhe mbetet model njerëzor dhe intelektual dhe se shpirti i saj u ndriçon rrugën përpara.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një ditë në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimim.
23. Pak elementare
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.

37. Janë legjendat.
38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpate të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimëveve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshqjellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në liter.
46. Fillojnë lejen.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në mode.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.

VERTIKAL

37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diqzonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një guajtje fluturimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e lisit.
1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajrore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hidhen të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllen me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullman aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



Gjeni ndryshimin

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

		8		3			6		
		5	6						1
		8							
								2	
	5	2			7				
	7		4		8	9			
		1					2		
6					2		9	8	
	9							1	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	7	2	9	5	6	8	4	3
9	5	4	3	8	7	6	1	2
6	8	3	2	1	4	9	5	7
2	9	1	5	6	3	4	7	8
5	6	7	4	2	8	3	9	1
4	3	8	7	9	1	5	2	6
7	2	5	6	3	9	1	8	4
3	1	9	8	4	2	7	6	5
8	4	6	1	7	5	2	3	9

Argëtim filozofik

- Gjithçka që kërkoi është një mundësi për të treguar se paratë nuk më bëjnë të lumtur.

- "Çdo ditë ngrihem dhe shikoj listën e "Forbes" për njerëzit më të pasur. Nëse nuk jam atje, shikoj në punë".

- Ka njerëz që shembin me karakterin e tyre, atë që ata ndërtojnë me mendjet e tyre.

- Mos kujtoni se nuk ka kafshë, vetëm dhe vetëm sepse pyllit është i qetë ...

- Ne jetojmë në një periudhë historike kur ndryshimi është aq i shpejtë sa që fillojmë të shohim të tashmen kur ajo tashmë po largohet.

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

1	K	U	L	2	T	14	4	9	7	4	19	
8	10	5		1	4	12	1	6	7	5	10	
10	4	7		4	1	2	8	10	6	4	7	5
18			1	7	5	8	9	4	2	10	4	
6	5	1		6	2	10	5	2	5		12	
7	1		17	5		1	5	10	17	4	2	
2	5	10	17	4	2		4	10	6	15	5	
8		2	8	12	15		6	10	17	5		
18	10	5	16	19	6		4	8	10	1		
6		7	5		6	11	5	9	19	6	7	
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6
12	5	1	5		12	1	6	15	4	2		8

M	A	S	H	U	R	K	A		I	R	A	K
E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A		
I	R	A	T	E	A	T	E	R	M	I	N	
E	R	A	P	O	L	A	R	T	A			
K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T	
L	P	O	L	I	G	A	M	I				
E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L		
K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E		
T	R	I	S	E	T	M	N	U	N			
I	T	T	U	T	U	I	T	I	D			
K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E		
E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T	

- Nuk jemi genie njerëzore që kanë përvojë shpirtërore.
- Jemi genie shpirtërore që kanë përvojë njerëzore.
- Gratë e bukura kurrë nuk dëshojnë në inteligjencën e vet, por gratë inteligjente çdoherë dëshojnë në bukurinë e vet.

Thënie të mençura

- Efkzistojnë krime më keq se sa të djegësh libra.
- Një nga këto është të mos i lexosh.
- Sa më shumë i ndershëm njeriu, aq më i keq fati i tij.

